

PLANI PËR LOKALIZIMIN E OBJEKTIVAVE TË ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM (SDG-VE) NË NIVELIN KOMUNAL

Komuna e Prishtinës



german
cooperation

DEUTSCHE ZUSAMMENARBEIT

Implementohet nga:

giz Deutsche Gesellschaft
für Internationale
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

Në bashkëpunim me:



Hartues: Klodeta Krasniqi, Development Solution (DS)

Përmbajtja

1. HYRJA

Qëllimi
Fushëveprimi
Metodologjia
Kufizimet

2. KOSOVA DHE QZHQ-TË

Çka është Agjenda 2030 për zhvillim të qëndrueshëm?
Si qëndron Kosova në raport me QZHQ-të?

3. PAJTUESHMËRIA E ZHVILLIMOR KOMUNAL SË PRISHTINËS ME QZHQ-TË

Cili është roli i administratës lokale në lokalizimin e QZHQ-ve?
Sa janë të integruara QZHQ-të në PZHK të Prishtinës?

Qëllimi 1. Pa Varfëri

Qëllimi 2. Zero Uri

Qëllimi 3. Shëndet i Mirë dhe Mirëqenie

Qëllimi 4. Arsimit Cilësor

Qëllimi 6. Ujë i Pastër dhe Kanalizime

Qëllimi 7. Energji e Përballushme dhe e Pastër

Qëllimi 8. Punë Dinjitoze dhe Rritje Ekonomike

Qëllimi 9. Industri, Inovacion dhe Infrastrukturë

Qëllimi 11. Qytete dhe Komunitete të Qëndrueshme

Qëllimi 12. Konsum dhe Prodhim i Përgjegjshëm

Qëllimi 15. Jeta në Stere

Qëllimi 16. Paqe dhe Drejtësi, Institucione të Forta

REKOMANDIMET – Hapat për integrimin e QZHQ-ve në Planin Zhvillimor Komunal të Prishtinës

4. PRIORITETET KARSHI INVESTIMEVE KOMUNALE

Cilat janë prioritetet komunale?

Trendi i investimeve kapitale

Të hyrat vjetore

Të hyrat vetanake

Prioritetet komunale për vitin 2030

REKOMANDIMET – Veprimet për përmbushjen e QZHQ-ve dhe treguesit përkatës për raportim të progresit

Arsimi

Shërbimet publike, emergjencat, parqet dhe hapësirat tjera publike

Zhvillimi ekonomik

Mjedisi

Shëndetësia, Mirëqenia Sociale dhe Qështjet Gjinore

Administratë publike, Prokurim, Financa

5. KAPACITETET KOMUNALE PËR MENAXHIMIN E LOKALIZIMIT TË QZHQ-VE

Sa ka komuna njohuri rreth QZHQ-ve?

Informimi

Integrimi i QZHQve në strategji lokale

Sa ka komuna përvojë dhe kapacitete njerëzore për hartimin e strategjive lokale?

Modaliteti i hartimit të strategjive lokale

Roli i stafit komunal në procesin e hartimit të strategjive lokale

Kapaciteti i stafit komunal në zhvillimin e politikave lokale – plane / strategji / programe zhvillimore të integruara dhe sektoriale

Sa ka komuna përvojë dhe mjete për menaxhimin e proceseve të hartimit të strategjive lokale?

Mjetet për menaxhimin e proceseve gjithëpërfshirëse

Kapaciteti i stafit komunal në organizimin, koordinimin dhe lehtësimin e proceseve gjithëpërfshirëse me ndjeshmëri gjinore

Sa ka komuna mjete dhe kapacitete njerëzore për monitorimin dhe vlerësimin e strategjive lokale?

Përvoja në monitorimin e zbatimit të strategjive

Raportet e progresit

Si qëndron komuna me të dhëna komunale dhe sa ka kapacitete njerëzore për menaxhim të bazës së të dhënave komunale?

Modaliteti i menaxhimit të të dhënave

Aktivitetet

Lloji i të dhënave

Posedimi i bazës së konsoliduar të të dhënave

Posedimi i protokolleve për menaxhimin e të dhënave

Bashkëpunimi me institucionet e tjera për bashkë-prodhimin e të dhënave

Kapacitetet njerëzore në krijimin, grumbullimin, përpunimin dhe përditësimin e të dhënave

Cili është koordinimi dhe bashkëpunimi ndër institucional dhe me shoqërinë civile?

Vlerësimi i bashkëpunimit me nivelin qendror

Informimi dhe përvoja në bashkëpunime ndër-komunale sa i përket strategjive dhe projekteve kapitale

Bashkëpunimi me shoqërinë civile

REKOMANDIMET – Fuqizimi i kapaciteteve komunale drejt Zhvillimit të Qëndrueshëm

Rregullorja komunale për QZHQ-të

Platforma institucionale për integrimin dhe raportimin rreth QZHQ-ve

Udhëzues për integrimin e QZHQ-ve, vlerësimin, monitorimin dhe raportimin e zbatimit të strategjive lokale përmes proceseve gjithëpërfshirëse

Fuqizimi i kapaciteteve komunale për hartimin dhe zbatimin e strategjive lokale

Krijimi i bazës së integruar/ përmbledhëse të të dhënave komunale

Hyrja

Qëllimi

Plani për lokalizimin e QZHQ-ve në nivelin komunal është raport vlerësues i cili ka për qëllim mbështetjen e komunave për ndërmarrjen e hapave konkret drejt përafrimit të politikave lokale dhe veprimeve konkrete me Agjendën 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm.

Fushëveprimi

Ky raport në vetëvete ofron një mjet pune lehtë të adaptueshëm për sektor të ndryshëm komunal, i cili:

Informon Komunën e Prishtinës rreth përmbytjes së QZHQ-ve, synimet relevante për nivelin lokal dhe përgjegjësitë e Komunës karshi kësaj kornize sipas kompetencave komunale të përcaktuara me Ligjin No. 030/L-040 për Vetëqeverisje Lokale. Poashtu, në mënyrë të gjithëmbarshme prezanton misionin e Agjendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe iniciativave që Republika e Kosovës ka ndërmarr për lokalizimin e QZHQ-ve në nivel vendi.

Vlerëson pajtueshmërinë e Planit Zhvillimor Komunal të Prishtinës me QZHQ-të, trendet e investimeve kapitale dhe të hyrave vjetore nga viti 2014 deri 2018. Poashtu, ky raport ofron një pasqyrë të kapaciteteve komunale për hartimin dhe menaxhimin e procesit, monitorimin e zbatimit dhe vlerësimin e strategjive lokale, menaxhimin e të dhënave komunale, si dhe bashkëpunimi dhe koordinimi ndër-institucional dhe me organizatat e shoqërisë civile.

Udhëzon Komunën e Prishtinës për hapat që duhet ndërmarr për përafrimin e PZHK-së me QZHQ-të, veprimet konkrete që komunat mund të ndërmarrin për përmbytjen e QZHQ-ve dhe treguesit përkatës për raportim të progresit në raport me përmbytjen e tyre. Poashtu, ky raport ofron rekomandime rreth mekanizmave komunal si zhvillimi i rregullorës komunale për QZHQ-të, sistemit të menaxhimit të të dhënave komunale, entiteteve institucionale për menaxhimin e procesit të lokalizimi të QZHQ-ve si dhe veprimet për fuziqimin e kapaciteteve njerëzore dhe mjeteve praktike për mbështetjen e shërbyesve civil në zhvillimin, monitorimin e zbatimit dhe vlerësimit të strategjive lokale përmes proceseve gjithëpërfshirëse.

Si i tillë, Plani për integrimin e QZHQ-ve në nivelin Komunal, shërben si model për vlerësimin e strategjive të tjera sektorale komunale, ndërsa ofron udhëzime të cilat aplikohen për të gjithë sektorët komunal.

Metodologjia

Plani për lokalizimin e QZHQ-ve në nivelin komunal është rezultat i shqyrtimit të dokumenteve komunale, raporteve globale dhe mësimave të nxjerra ndërkombëtare në lokalizimin e QZHQ-ve. Konkluzionet dhe rekomandimet janë ndërtuar mbi bazën e anketimit të grupit punues të angazhuar në kuadër të projektit përmes pyetësorit I cili ka adresuar aspekte të ndryshme të zhvillimit dhe menaxhimit të zbatimit të politikave lokale duke përfshirë *njohurinë rreth QZHQ-ve dhe iniciativat e deritanishme të nivelit lokal në lokalizimin e tyre, përvojën dhe rolin e shërbyesve civil në hartimin e strategjive lokale, menaxhimin e proceseve të hartimit të strategjive, monitorimin e zbatimit dhe vlerësimit të strategjive lokale, statusin e strategjive lokale, disponueshmërisë së bazës së të dhënave komunale dhe protokolet përkatëse të menaxhimit, bashkëpunimi dhe koordinimi me nivelin qendror dhe shoqërisë civile, si dhe kapacitetet njerëzore për zbatimin e aktiviteteve të listuara*. Gjetjet dhe rekomandimet e raportit janë konfirmuar dhe mbindërtuar gjatë punëtorisë dy-ditore me komunat partnere. Grupi punues nga Komuna e Prishtinës është përbërë nga përfaqësues të

Drejtorisë për Planifik Strategjik dhe Zhvillim të Qëndrueshëm. Poashtu, gjetjet dhe rekomandimet e raportit janë prezantuar dhe diskutuar me forume të zgjeruara të shërbyesve civil në komunat përkatëse.

Kufizimet

Një nga kufizimet e këtij raporti është përfaqësimi i limituar sektoral në grupin punues, me çrast gjetjet rreth kapaciteteve komunale njerëzore dhe financiare japin orientime fillestare për hapat e më tutjeshëm drejt lokalizimit të QZHQ-ve. Për të mbushur zbrazëti eventuale, ky raport rekomandon që zbatimi i veprimeve rreth fuqizimit të kapaciteteve komunale duhet të paraprihet nga analiza të thukëta dhe gjithëpërfshirëse të sektorëve relevant rreth nevojave reale dhe prioriteteve strategjike komunale. Poashtu, ky raport ofron informata fillestare rreth trendit të të hyrave vjetore dhe vetanake. Analizat e më tutjeshme financiare duhet të mbështesin hapa konkret rreth disenjimit të mekanizmave të përshtatshëm për rritjen e të hyrave vetanake komunale dhe mobilizimin e burimeve financiare për lokalizimin e QZHQ-ve.

KOSOVA DHE QZHQ-TË

Çka është Agjenda 2030 për zhvillim të qëndrueshëm?

Agjenda 2030 për zhvillim të qëndrueshëm është plan i përbashkët i veprimit për njerëzit, planetin dhe prosperitetin, e cila ka për qëllim orientimin e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, social dhe mjedisor në mënyrë të balancuar dhe integruar.

Kjo kornizë ka për qëllim të stimulojnë veprimin gjatë 15 viteve të ardhshme në fushat me rëndësi kritike për njerëzimin dhe planetin, si:



Çrrënjosjen e varfërisë dhe urisë, në të gjitha format dhe dimensionet e tyre, dhe krijimin e kushteve në menyrë që të gjitha qeniet njerëzore mund të përmbushin potencialin e tyre në dinjitet dhe barazi dhe në një mjedis të shëndetshëm.



Mbrojtjen e planetit nga degradimi, duke përfshirë konsumin dhe prodhimin e qëndrueshëm, duke menaxhuar në mënyrë të qëndrueshme burimet natyrore dhe duke ndërmarrë veprime urgjente në ndryshimet klimatike, në mënyrë që të mbështesë nevojat e gjeneratave të tanishme dhe të ardhshme.



Krijimin e kushteve që të gjitha qeniet njerëzore mund të gëzojnë jetë të begatë dhe të përmbushur dhe se përparimi ekonomik, social dhe teknologjik ndodh në harmoni me natyrën.



Nxitja e shoqërive paqësore, të drejta dhe gjithëpërfshirëse të cilat janë të lira nga frika dhe dhuna. Nuk mund të ketë zhvillim të qëndrueshëm pa paqe dhe nuk ka paqe pa zhvillim të qëndrueshëm.



Mobilizimi i mjeteve të nevojshme për të zbatuar këtë Agjendë nëpërmjet një Partneriteti Global të Rinjizur për Zhvillim të Qëndrueshëm, të bazuar në frymën e solidaritetit global të fuqizuar, të fokusuar në veçanti në nevojat e më të varfërve dhe më të rrezikuarve dhe me pjesëmarrjen e të gjitha vendeve, të gjithë aktorët dhe të gjithë njerëzit.

Agjenda 2030 është miratuar më datë 25 shtator 2015 nga Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian, me çrast akter eminent u zotuan që pëpjekjet për zhvillim të qëndrueshem ti bashkërendojnë në funksion të përmbushjes së kësaj agjende. Agjenda 2030 është e zbërthyer në 17 Qëllime, 169 Synime dhe 230 Tregues, të cilat për bazë kanë Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit dhe sfidat në rritje e sipër.



Si qëndron Kosova në raport me QZHQ-të?

Kuvendi i Republikës së Kosovës, në datën 25 janar 2018 ka miratuar **rezolutën për miratim të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm**. Përmes kësaj rezolute, institucionet e Kosovës zotohen që:

- Angazhohen për zbatimin e kornizes përmes legjislationit dhe miratimit në kohë të buxhetit të nevojshme
- Rishikimi i skemës organizative institucionale, përfshirë komisionet dhe proceset e brendshme në shërbim të integritetit të QZHQ-ve në të gjitha sferat e punës përmes komisioneve përkatëse, nën koordinimin e Komisionit parlamentar për shëndetësi, punë dhe mirëqenie
- Përcjellë zbatimin e Strategjisë kombëtare të qeverisë për zhvillim, strategjive të integritetit në BE dhe strategjive të tjera që integrojnë QZHQ-të duke përfshirë mbajtjen e takimeve të rregullta me shoqërinë civile, sektorin privatë dhe qytetarët në përgjithësi
- Përcjellë zbatimin e strategjisë kombëtare të zhvillimit, dhe QZHQ-të përmes rishikimit të plotë vjetor
- Shqyrton raportet kombëtare të progresit që do të mund të paraqiten nga qeveria në kombet e bashkuara si pjesë e shqyrtimit global në forumin e nivelit të lartë të OKBsë për zhvillim të qëndrueshëm
- Organizon në fund të çdo viti mbledhje me Qeverinë, komunitetin ndërkombëtar, organizatat e shoqërisë civile dhe qytetarët në përgjithësi

Kjo rezolutë ka nxitur një mori veprimesh për vlerësimin dhe krijimin e mekanizmave të nevojshëm institucional për lokalizimin e QZHQ-ve, sic janë:

- Formimi i Këshillit për Zhvillim të Qëndrueshëm, që udhëhiqet nga Kryetari i Komisionit Parlamentar për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie. Funkcioni primar i këshillit është monitorimi i zbatimit të QZHQ-ve përmes integritetit adekuat në fushat përkatëse të punës së institucioneve vendore. Këshilli përbehet nga anëtarët e përhershëm me kompetenca vendim-marrëse (the Assembly Committee chairs; the Assembly Secretary General; members of the Parliamentary Committee on Health, Labour, Social Welfare; representatives of Women Caucus and other parliamentary informal groups; other interested parliamentarians) dhe partnerët e jashtëm të cilët kanë rol konsultativ (representatives of the Cabinet of the President of the Assembly; representatives of the Office of the Prime Minister; representatives from the Institution of the President; representatives from Association of Kosovo Municipalities; Kosovo Agency of Statistics; heads of the UN Kosovo Team; other interested international organizations; Kosovo Women's Network; Civikos; KCSF and other CSO representatives).
- Integrimi i QZHQ-ve në kuadër të politikave dhe programeve të departamenteve dhe agjencive, proces i cili koordinohet nga Zyra për Planifikim Strategjik, Zyra e Kryeministrit. Dokumenti i parë i nivelit të lartë strategjik i cili do të integroj treguesit e QZHQ-ve është Strategjia për Zhvillim Kombëtar 2016-2021, e cila shërben për raportim për 40 tregues, dhe do të raportohen në kuadër të Raportit të Monitorimit të QZHQ-ve. Sa i përket strategjive sektorale, 25 prej 50 sosh janë përafruar me QZHQ-të.
- Informimi dhe promovimi i QZHQ-ve, si (1) instalacion i vendosur para Kuvendit të Kosovës që simbolizon përkushtimin e Kosovës në përmbytjen e QZHQ-ve.

Çka nënkuptojmë me

“Lokalizimin e QZHQ-ve”

Procesi i definimit, zbatimit dhe monitorimit të strategjive në funksion të përmbytjes së QZHQ-ve, duke përfshirë përcaktimin e qëllimeve, dhe synimeve, mobilizimi i burimeve njerzore, hapësirave dhe financiare për zbatimin e tyre, si dhe përshtatja dhe shfrytëzimi i treguesve për matjen e progresit drejt përmbytjes së këtyre qëllimeve.



**PAJTUESHMËRIA E
PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL SË PRISHTINËS
ME QZHQ-TË**

Cili është roli i administratës lokale në lokalizimin e QZHQ-ve?

Qeveritë lokale kanë rol thelbësor për nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës brenda territoreve të tyre. Përmes zhvillimit të politikave lokale, investimeve direkte kapitale dhe përmirësimit të shërbimeve, ato janë katalizator të ndryshimit që shërbejnë si urë lidhëse në mes të qëllimeve globale dhe komuniteteve lokale.

Agjenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, Neni 34.

“Ne e pranojmë se zhvillimi dhe menaxhimi i qëndrueshëm urban janë vendimtarë për cilësinë e jetës së popullit tonë. Ne do të punojmë me autoritetet lokale dhe komunitetet për të rinovuar dhe planifikuar qytetet tona dhe vendbanimet njerëzore në mënyrë që të nxisim kohezionin e komunitetit dhe sigurinë personale dhe të stimulojmë rritjen dhe punësimin. Ne do të reduktojmë ndikimet negative të aktiviteteve urbane dhe të kimikateve që janë të rrezikshme për shëndetin e njeriut dhe mjedisin, duke përfshirë menaxhimin e sigurt të mjedisit dhe përdorimin e sigurt të kimikateve, reduktimin dhe riciklimin e mbeturinave dhe përdorimin më efikas të ujit dhe energjisë. Dhe ne do të punojmë për të minimizuar ndikimin e qyteteve në sistemin global të klimës. Ne gjithashtu do të marrim parasysh trendet demografike dhe parashikimet në strategjitë dhe politikat kombëtare të zhvillimit rural dhe urban. Ne presim që konferenca e ardhshme e Kombeve të Bashkuara mbi Strehimin dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm Urban të mbahet në Quito”

QZHQ 11 “Ndërtimi i qyteteve dhe i vendbanimeve gjithëpërfshirës, të sigurt, rezistentë dhe të qëndrueshëm” objektivi i dedikuar qyteteve dhe vendbanimeve në tërësi, demonstroi njohjen e fuqisë transformuese të urbanizimit për zhvillim, dhe rolin e liderëve të qytetit në lëvizjen e ndryshimeve globale nga poshtë lartë.

QZHQ-të janë platformë ideale për mobilizimin e palëve të ndryshme të interesit dhe ndërtimit të partneritetit (QZHQ 17) në mes të qeverisë lokale, akademisë, komunitetit të biznesit, institucionet e tjera publike, organizatat e shoqërisë civile dhe komuniteti i gjerë, drejt qëllimeve të përbashkëta, duke promovuar ndërtimin e institucioneve efektive, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse (QZHQ 16).

Megjithatë, roli i qeverisë lokale në përmbushjen e QZHQ-ve shkon përtej Qëllimit 11, 16 apo 17. Të gjitha QZHQ-të kanë synime që ndërlidhen në mënyrë direkte apo indirekte me punën e qeverisë lokale. Kontributi i komunave është kyç në përmbushjen e rreth 65% të Agjendës 2030, me rol aktiv si partnerë në krijimin dhe përcaktimin e politikave dhe programeve të QZHQ, si dhe në realizimin dhe monitorimin e progresin në arritje të QZHQ-ve.

Hapat e propozuar bazuar në praktika të mira për lokalizimin e QZHQ-ve në nivelin komunal janë:

Hapi 1. Ngritja e vetëdijes për QZHQ-të: Informimi rreth QZHQ-ve dhe përfshirja e palëve të ndryshme të interesit në dialog gjithëpërfshirës për rolin përkatës në zhvillimin e qëndrueshëm.

Hapi 2. Themelimi i agjendës lokale të QZHQ-ve: Prioritizimi i qëllimeve dhe synimeve globale në koordinim me sektorin civil dhe komunitetin e bizneseve, integrimi i tyre në strategji lokale dhe pajtueshmeria rreth hapave të përbashkët dhe vetanë për zbatimin e tyre.

Hapi 3. Planifikimi i zbatimit të QZHQ-ve: Mobilizimi i burimeve të nevojshme për realizimin e veprimeve afatshkurte, në funksion të vizionit afatgjatë, identifikimi dhe menaxhimi i konflikteve për zhvillim mirë të balancuar social, ekonomik dhe mjedisor.

Hapi 4. Monitorimi dhe vlerësimi: Së fundi, për të qenë në gjendje për të ndjekur progresin dhe sigurimi i llogaridhënies, monitorimit dhe kornizat e vlerësimit duhet të jenë në vend. Vetëm duke shqyrtuar programet dhe politikat mund të përcaktojnë ndikimin dhe efikasitetin e tyre.

Ky raport fokusohet në Hapin 2 duke vlerësuar integrimin e QZHQ-ve relevante në strategjitë lokale, identifikuar QZHQ-të për të cilat Komunitat janë përgjegjës kryesor, veprimet që komunitat duhet ndërmarrë për fuqizimin e kapaciteteve dhe orientimin e investimeve në funksion të përmbushjes së QZHQ-ve.

Detyrat e komunave në përmbushjen e QZHQ-ve përkojnë me kompetencat komunale të përcaktuara me Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale përfshirë **kompetencat vetanake** si

- zhvillimin lokal ekonomik;
- planifikimin urban dhe rural;
- shfrytëzimin e tokës dhe zhvillimin territorial; zbatimin e rregulloreve të ndërtimit dhe standardeve për kontrollimin e ndërtimit; mbrojtjen e mjedisit lokal;
- ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale, përfshirë furnizimin me ujë, kanalizimin dhe drenazhin, trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbeturinave, rrugëve lokale, transportit lokal dhe skemave të nxehjes lokale;
- adresimin e rasteve emergjente lokale;
- ofrimin e arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve edukative, punësimin, pagesën e rrogave dhe trainimin e instruktorëve dhe administratorëve të arsimit; promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut;
- ofrimin e përkujdesit publik primar shëndetësor;
- ofrimin e shërbimeve familjare dhe shërbimeve të tjera të mirëqenies sociale, siç është përkujdesi për të cënueshmit, strehimin familjar, përkujdesin fëmijnor, përkujdesin për të moshuarit, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e këtyre qendrave përkujdesëse, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimit të profesionistëve të mirëqenies sociale;
- banimin publik;
- shëndetësinë publike;
- licencimin e shërbimeve publike dhe objekteve, duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me argëtimin,

aktivitete kulturore dhe të lira, ushqimin, strehimin, tregjet, shitësit në rrugë, transportimin lokal publik dhe taksitë;

- emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike;
- ofrimin dhe mirëmbajtjen e parqeve dhe hapsirës publike;
- turizmit;
- aktivitetet kulturore dhe të lira; apo **kompetencave të caktuara të deleguara** si distribuimin e pagesave të ndihmës sociale (me përjashtim të pensioneve) dhe mbrotja e pyjeve që ndodhen në territorin e komunës në kuadër të autorizimeve të deleguara nga autoriteti qendror, duke përfshirë edhe dhënien e licencave për prerjen e drunjve në bazë të rregullave të miratuara nga Qeveria;

Gjithesesi, në bazë të raportit të Instituti GAP “Sa kanë kompetenca vetanake komunat?”, kompetencat vetanake të komunave, të listuara në nenin 17 të Ligjit për vetëqeverisje lokale, në masë të madhe janë kompetenca të cilat komunat i ushtrojnë nën varësi të pushtetit qendror. Shembull i tillë është furnizimi me ujë të pijës, ku edhe pse Ligji për vetëqeverisje lokale u jep kompetenca komunave dhe i mban përgjegjëse ato për furnizim me ujë në praktikë furnizimi me ujë është kompetencë e ndërmarrjeve publike rajonale, të cilat I japin llogari Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik. Edhe menaxhimi I mbeturinave nuk është kompetencë vetanake e komunës, por kjo është detyrë e ndërmarrjeve publike rajonale për menaxhimin e mbeturinave, të cilat menaxhohen nga një koncorsium I komunave, e ku zakonisht komunat më të vogla mbivotohen nga komunat më të mëdha. Raste të ngjashme hasen edhe në fushën e emergjencave, shëndetësisë, arsimit dhe në fusha të tjera.

Sa janë të integruara QZHQ-të në PZHK të Prishtinës?

Komuna e Prishtinës është në proces të hartimit të Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) të ri dhe të planeve sektorle, përfshirë Vlerësimin Strategjik Mjedisor dhe Planin e Mobilitetit.

PZHK-ja e Komunës së Prishtinës përkufizon vizionin afatgjatë të zhvillimit të komunës, ndërsa zbërthen qëllimet, objektivat dhe veprimet për 8 vite. Ky dokument ka gjithësejt 7 qëllime dhe 35 synime të cilat adresojnë zhvillimin ekonomik, rrjetizimin global të Prishtinës, shërbimet publike, mobiliteti, trashëgimia kulturore dhe natyrore, zhvillimi rural dhe urbanizimi I qëndrueshëm.

Ky dokument integron pjesërisht me Agjendën 2030. PZHK-ja adreson 12 qëllime dhe 33 synime (42% të synimeve relevante për nivelin lokal, 7% e synimeve (7) janë në pajtueshmëri të plotë, 26% (25) pajtueshmëri të pjesëshme, 48% (45) synime nuk janë adresuar fare ndërsa 17% (16) nuk përkojnë me mandatin e PZHK-së.

Qëllimet e PZHK-së në masën më të madhe përkojnë me Qëllimin 11, 8 dhe 9, përderisa Qëllimi 1, 5, 10, 13 dhe 14 nuk janë adresuar fare. (Shih figurën më poshtë)

Qëllimet më mirë të integruara në kuadër të PZHK-së janë Qëllimi 7 dhe 9 të integruara 100%, dhe Qëllimi 11 me pajtueshmëri të rreth 80% të synimeve relevante për nivelin lokal.

Plani Zhvillimor Komunal (PZHK) është instrument afatgjatë i planifikimit strategjik që është në përputhje me parimet e planifikimit hapësor të përcaktuara në Planin Hapësor të Kosovës (PHK). PZHK përcakton drejtimit e zhvillimit duke analizuar burimet sociale, ekonomike dhe mjedisore në mbështetje të qëndrueshmërisë komunale. Gjithashtu, PZHK ofron një kornizë të zhvillimit hapësor, strukturë dhe organizim përkatës, që drejton planifikimin dhe zhvillimin e ardhshëm hapësor për mjediset lokale të ndërtuara dhe të pandërtuara, të cilat janë të përcaktuara për arritjen e qëllimeve që lidhen me:

- zhvillimin e vendbanimeve policentrike, kompakte dhe me densitet të lartë;*
- rritjen e rrjeteve dhe shërbimeve sociale, teknike dhe të transportit;*
- rritjen e shpejtë ekonomike dhe mundësitë e punësimit;*
- përdorimin efikas të pyjeve dhe bujqësisë, si dhe tokës ndërtimore;*
- mbrojtjen/ruajtjen e trashëgimisë natyrore dhe kulturore;*
- administratë efikase dhe efektive komunale.*



2 ZERO URI



Ky qëllim ka të bëjë me sigurimin e kushteve që të gjithë të mund të gëzojnë një vend të sigurtë, ushqyerje të mirë, gjatë gjithë vitit

Synimet relevante të qëllimit 2 “Eliminimi i urisë, arritja e sigurisë ushqimore dhe përmirësimi i ushqyerjes, si dhe nxitja e bujqësisë së qëndrueshme” për nivelin lokal janë:

2.1 Deri në vitin 2030, të eleminohet uria dhe të sigurohet e drejta e të gjithë njerëzve, në veçanti e të varfërve dhe e atyre që jetojnë në gjendje të vështirë, përfshirë foshnjat, për të patur ushqim të sigurt dhe të mjaftueshëm përgjatë gjithë vitit.

2.2 Deri në vitin 2030, të eleminohen të gjitha format e kequshqyerjes, përfshirë edhe arritjen, deri në 2025-ën, të treguesve të miratuar ndërkombëtarisht lidhur me frenimin e zhvillimit të fëmijëve nën 5 vjeç dhe të adresohen nevojat për ushqim të vajzave adoleshente, të grave shtatzëna dhe atyre që ushqejnë foshnjat me gji, si dhe të personave të moshuar.

2.3 Deri në vitin 2030, të dyfishohet prodhimi bujqësor dhe të ardhurat e prodhuesve ushqimorë në shkallë të vogël, veçanërisht e grave, popujve indigjenë, familjeve fermere, blegtorëve dhe peshkatarëve, përfshirë edhe përmes qasjes së sigurt dhe të barabartë tek toka, burimet e tjera prodhuese, njohuritë, shërbimet financiare, tregjet dhe mundësitë për shtimin e vlerës dhe punësimin jashtë sektorit bujqësor.

2.4 Deri në vitin 2030, të sigurohen sisteme të qëndrueshme të prodhimit të ushqimit dhe të zbatohen praktika ripërtëritëse bujqësore që rrisin rendimentin dhe prodhimin, ndihmojnë në ruajtjen e ekosistemeve, forcojnë kapacitetin për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, motit ekstrem, thatësirave, përmbytjeve dhe fatkeqësive të tjera dhe që në mënyrë progresive përmirësojnë cilësinë e tokës bujqësore.

Kompetencat rreth menaxhimit të tokës, ndërgjegjësimi të komunitetit të gjerë në veçanti në zonat rurale, investimeve në infrastrukturën e nevojshme për transport, magazinim dhe plasim të produkteve ushqimore në treg e bëjnë komunën përgjegjësin kyç në nxitjen e zhvillimit të nevojshëm për përmbushjen e synimit 2.3 dhe 2.4. Ndërsa sa i përket eliminimit të urisë dhe kequshqyerjes, përkatësisht synimi 2.1 dhe 2.2 administrata lokale është përgjegjëse të identifikoj rastet e tilla, sidomos tek fëmijet.

Qëllimet dhe synimet e PZHK-së adresojnë qëllimin e dytë në mënyrë të pjesshme, kryesisht në nxitjen e zhvillimit ekonomik, përderisa eliminimi I urisë dhe përmirësimi I ushqyerjes si të tilla nuk adresohen fare.

Katër nga synimet e Qëllimit 2 të QZHQ-ve konsiderohen të jenë relevante për nivelin lokal, prej të cilëve dy janë të integruara në kuadër të Kornizes Zvillimore të PZHK-së.



E synimeve relevante të Qëllimit 2 kanë pajtueshmeri të pjesëshme me synimet e PZHK-së

Synimi 2.3 i QZHQ-ve adresohet nga një qëllim i PZHK-së dhe dy synime përkatëse:

QËLLIMI 6 Zhvillimi rural dhe ruajtja e trashëgimisë natyrore

Synimi 6.1 Vlerësimi i tokës pjellore bujqësore (përdorimi efikas i tokës bujqësore dhe mbështetja për produktivitet ekologjik, multi-funksionalitetit, tregut të fermerëve, shërbimet e sigurta për fshatrat rurale);
Synimi 6.2 Mbështetja e fermerëve me mjete teknike ose financiare në ndërtimin e serrave, rregullimin dhe ndërtimin e fermave të vogla. Nxitjen e investimeve në pyllëzimin e përdorimi joefikas;

Synimi 2.4 i QZHQ-ve adresohet nga një qëllim i PZHK-së dhe një synim përkatës:

QËLLIMI 6 Zhvillimi rural dhe ruajtja e trashëgimisë natyrore

Synimi 6.1 Vlerësimi i tokës pjellore bujqësore (përdorimi efikas i tokës bujqësore dhe mbështetja për produktivitet ekologjik, multi-funksionalitetit, tregut të fermerëve, shërbimet e sigurta për fshatrat rurale);

Sa I përket synimit 2.3, PZHK orienton përpjekjen në zhvillimin bujqësor, mirëpo nuk parashtrohet shkallën e synuar të rritjes bujqësore. Si e tillë, edhe pse integron disa nga komponentet e synimit, nuk e adreson atë në plotni. Poashtu PZHK synon mbështetjen e prodhimit ekologjik, mirëpo nuk trajton në plotni sistemin e prodhimit të ushqimit, me çrast ka pajtueshmëri të pjesëshme me synimin 2.4 të QZHQ-të.

3 SHËNDET I MIRE DHE MIRËQENIE



Ky qëllim ka të bëjë me ofrimin e shërbimeve dhe ndihmës që njerëzit të jetojnë një jetë më të shëndetshme

Synimet relevante të qëllimit 3 “Sigurimi i jetës së shëndetshme dhe promovimi i mirëqenies për të gjithë në të gjitha moshat ” për nivelin lokal janë:

3.1 Deri në vitin 2030, të zvogëlohet raporti global i vdekshmërisë së nënave në më pak se 70 vdekje për 100,000 lindje.

3.2 Deri në vitin 2030, të parandalohen vdekjet e të porsalindurve dhe e fëmijëve nën moshën 5 vjeç, ku të gjitha vendet të synojnë zvogëlimin e vdekshmërisë të të porsalindurve në më pak se 12 vdekje për 1,000 lindje dhe të vdekshmërisë së fëmijëve nën 5 vjeç në më pak se 25 vdekje për 1,000 lindje.

3.3 Deri në vitin 2030, të eliminohen epidemitë e SIDA-s, të tuberkulozit, të malaries dhe të sëmundjeve tropikale të neglizhuara dhe të luftohet hepatiti, sëmundjet që transportohen përmes ujit dhe sëmundjet e tjera ngjitëse.

3.6 Deri në vitin 2020, të përgjysmohet numri global i vdekjeve dhe i plagosjeve nga aksidentet rrugore.

3.7 Deri në vitin 2030, të sigurohet qasja e gjithëanshme në shërbimet e kujdesit shëndetësor seksual dhe riprodhues, përfshirë dhe planifikimin familjar, informimin dhe edukimin, dhe futjen e shëndetit riprodhues në strategjitë dhe programet kombëtare.

3.9 Deri në vitin 2030, të zvogëlohet dukshëm numri i vdekjeve dhe i sëmundjeve nga kimikatet e rrezikshme dhe nga ndotja e ajrit, e ujit dhe e tokës.

3.a Të forcohet zbatimi i Konventës Kuadër të Organizatës Botërore të Shëndetësisë për kontrollin e konsumit të duhanit, sipas rastit, në të gjitha vendet.

3.b Të mbështetet kërkimi dhe zhvillimi i vaksinave dhe i barnave për sëmundjet e transmetueshme dhe jo të transmetueshme, të cilat prekin, kryesisht, vendet në zhvillim, të sigurohet përdorimi i barnave dhe i vaksinave të rëndësishme dhe të përballueshme, në përputhje me Deklaratën e Dohas mbi Marrëveshjen e të Drejtave të Pronësisë Intelektuale për Çështjet lidhur me Tregtinë (TRIPS) dhe Shëndetin Publik, e cila konfirmon të drejtën e vendeve në zhvillim për të përdorur plotësisht dispozitat e Marrëveshjes TRIPS në lidhje me lehtësitë për të mbrojtur shëndetin publik, dhe në veçanti, për të siguruar përdorimin e barnave për të gjithë.

3.c Të rriten, ndjeshëm, financimet për shëndetësinë, për rekrutimin, për zhvillimin, për trajnimin dhe për mbështetjen e punonjësve në sektorin shëndetësor në vendet në zhvillim, e në veçanti në vendet më pak të zhvilluara dhe në shtetet-ishuj të vegjël në zhvillim

Komunat kanë përgjegjësi të plotë në ofrimin e shërbimeve shëndetësore primare dhe alokimin e buxhetit për ofrimin e infrastrukturës të nevojshme teknike. Poashtu, përmes masave për mbrojtjen e mjedisit, largimin e deponive ilegale të mbeturinave, investimin në transportin publik dhe rrjetin e hapësirave të gjelbra publike kontribuon në përmirësimin e kualitetit të ajrit dhe burimeve të ujit. Ky rol bënë Komunën kontribues kyç në përmbushjen e tri synimeve të renditura në kuadër të qëllimit 3, përkatësisht synimi 3.7, 3.9 dhe 3.c.

Qëllimi 3 është integruar pjesërisht në kornizën zhvillimore të PZHK-së, duke trajtuar sigurinë në trafik, shëndetin dhe higjienën përmes luftimit të ndotjes së mjedisit dhe investimin për rregullimin e infrastrukturës shëndetësore., ndërsa dy nga synimet si 3.3 dhe 3.b nuk përkojnë me mandatin e PZHK-së.

Synimi 3.6 i QZHQ-ve përkon me një nga qëllimet dhe synimet e PZHK-së:

QËLLIMI 4 Zhvendosja e njerëzve dhe mallrave në mënyrë efikase dhe të qëndrueshme

Synimi 4.6 Zhvillimi i një rrjeti për shtigje të çiklistëve, përmirësimin e sigurisë së këmbësorëve dhe rrugëve me pengesë të lirë;

Synimi 3.9 i QZHQ-ve përkon me një nga qëllimet dhe synimet e PZHK-së:

QËLLIMI 3 Qytetarëve t'u sigurohet një sistem efektiv dhe cilësor i shërbimeve publike dhe një mjedis i rehatshëm urban


Synimi 3.5 Të ofrohet infrastrukturë e përshtatshme për shëndet dhe higjienë nëpër qytet dhe fshatra (furnizim me ujë, hedhja e mbeturinave, energjia, menaxhimi i mbeturinave, zona të gjelbërta).

Synimi 3.c adresohet nga një qëllim dhe një synim perkatës të PZHK-së:

QËLLIMI 3 Qytetarëve t'u sigurohet një sistem efektiv dhe cilësor i shërbimeve publike dhe një mjedis i rehatshëm urban

Synimi 3.2 Të ofrohen shërbime cilësore shëndetësore dhe të mirëqenies sociale, duke rritur kapacitetet fizike dhe njerëzore të institucioneve të shëndetit, ndërtimi i spitalit të qytetit, të ofrohen shërbime shëndetësore të përshtatshme në lidhje me standardet e shëndetit;

PZHK synon përmirësimin e sigurisë për këmbësor, mrëpo nuk ndan cakun njejt apo fushëveprimin me synimin e QZHQ-së sa i përket përgjysmimit të vdekjeve dhe plagosjeve nga aksidentet rrugore. Sa i përket synimit 3.9 edhe pse PZHK-ja nuk adreson në mënyrë specifike zvogëlimin e numrit të vdekjeve dhe sëmundjeve nga ndotja, adreson ndotjen dhe masat për parandalimin e saj.



E synimeve relevante të Qëllimit 3 kanë pajtueshmëri të pjesëshme me synimet e PZHK-së, ndërsa 22% e tyre nuk janë relevante për PZHK-në.

4 ARSIM CILËSOR



Ky qëllim ka të bëjë me sigurimin e kushteve që të gjithë të mund studiojnë, të mësojnë dhe të përmbushin potencialin e tyre

Synimet relevante të qëllimit 4 “Sigurimi i arsimit cilësor gjithëpërfshirës dhe të barabartë dhe nxitja e mundësive për edukim gjatë gjithë jetës për të gjithë” për nivelin lokal janë:

4.1 Deri në vitin 2030, të sigurohet që të gjithë vajzat dhe djemtë të përfundojnë arsimimin fillor dhe 9 vjeçar pa pagesë, të barabartë dhe cilësor, që çon në rezultate të rëndësishme dhe efikase të të mësuarit.

4.2 Deri në vitin 2030, të sigurohet që të gjithë vajzat dhe

djemtë kanë të drejtë për zhvillim cilësor që në fëmijërinë e hershme, për përkujdesje dhe për edukim parashkollor, në mënyrë që të jenë gati për arsimim fillor.

4.3 Deri në vitin 2030, të sigurohen qasje të barabartë për të gjithë gratë dhe burrat që të ndjekin arsimin profesional, teknik apo atë universitar me kosto të përballueshme dhe cilësor.

4.4 Deri në vitin 2030, të sigurohet rritje e ndjeshme e numrit të të rinjve dhe të të rriturve që kanë aftësitë e nevojshme, përfshirë aftësitë teknike dhe ato profesionale, për t’u punësuar, për punë cilësore dhe sipërmarrje.

4.5 Deri në vitin 2030, të eliminohet pabarazia gjinore në arsim dhe të sigurohet qasje e barabartë në të gjitha nivelet e arsimimit dhe të trajnimit profesional për grupet më të ndjeshme, përfshirë personat me aftësi të kufizuara, popujt indigjenë dhe fëmijët e pambrojtur.

4.7 Deri në vitin 2030, të sigurohet që të gjithë nxënësit të marrin njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të promovuar Zhvillimin e Qëndrueshëm, përfshirë, ndër të tjera, Edukimin për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe një mënyrë jetese të qëndrueshme, të drejtat e njeriut, barazinë gjinore, përkrahjen e kulturës së paqes dhe jo të dhunës, qytetarinë globale dhe vlerësimin ndaj shumëllojshmërisë së kulturave dhe të kontributit që jep kultura për Zhvillimin e Qëndrueshëm.

4.a Të ndërtohen dhe të përmirësohen objektet arsimore të përshtatshme për fëmijët, për personat me aftësi të kufizuara dhe për ndjeshmërinë gjinore dhe të sigurohen mjedise të sigurta, jo të dhunshme, gjithëpërfshirëse dhe efektive në të mësuar për të gjithë.

Komunat janë organi kompetent për ofrimin e arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, duke përfshirë ndërtimin e infrastrukturës fizike mirëpo edhe angazhimin dhe fuqizimin e kapaciteteve njerëzore, si dhe të siguroj qasje gjithëpërfshirëse në arsim sidomos atë parashkollor dhe fillor. Synimet të cilat komuna është përgjegjëse t’i përmbushë janë synimi 4.1, 4.2, 4.5 dhe 4.a të cilat adresojnë po të njëjtat qështje të listuara, kompetencë e komunës.

PZHK-ja integron qëllimin e katërt në mënyrë të pjesëshme, duke përfshirë, ofrimin e infrastrukturës fizike të përshtatshme për të gjithë.

Kjo kornizë përfshinë dy nga shtatë synimet relevante për nivelin komunal, përkatësisht 28 %, duke përjashtuar synimet 4.1, 4.2 dhe 4.3 që adresojnë qasjen në arsimin parashkollor, fillor të mesëm dhe atë të lartë, 4.4 fuqizimit të kapaciteteve tek të rriturit dhe 4.7 që i dedikohet programeve arsimore rreth zhvillimit të qëndrueshme.

Synimet 4.5 dhe 4a të QZHQ-ve adresohen nga një qëllim i synim përkatës:



E synimeve relevante të Qëllimit 4 kanë pajtueshmeri të pjesëshme me synimet e PZHK-së

PZHK-së dhe një

QËLLIMI 3 Qytetarëve t'u sigurohet një sistem efektiv dhe cilësor i shërbimeve publike dhe një mjedis i rehatshëm urban

Synimi 3.1 Të ofrohet edukim cilësor dhe gjithëpërfshirës: Krijimi i një rrjeti të shkollave që i përmbushin nevojat e qytetarëve me qasje të duhur dhe objekte të përshtatshme: laboratorë, salla sporti, rrjet kompjuterik dhe internet; zgjerimi i rrjetit të institucioneve, parashkollore dhe shkollave në zonat rurale;

Synimi 4.5 është integruar pjesërisht me që PZHK synon edukim cilësor dhe gjithëpërfshirës, edhe pse nuk specifikon në mënyrë eksplicite luftimin e pabarazive gjinore apo kategoritë më të ndjeshme që duhet t'u kushtohet vëmendje e veçant, si në synimin 4.5 dhe 4.a të QZHQ-ve;

6 UJË I PASTER DHE KANALIZIME



Ky qëllim synon qasjen e të gjithëve në ujë të pastër të pijes dhe kanalizim

Synimet relevante të qëllimit 6 “Sigurimi i furnizimit dhe i menaxhimit të qëndrueshëm të ujit dhe kanalizimeve për të gjithë” për nivelin lokal janë:

6.1 Deri në vitin 2030, të arrihet furnizimi i gjithanshëm dhe i barabartë me ujë të pijshëm, të sigurt dhe të përballueshëm për të gjithë;

6.2 Deri në vitin 2030, të mundësohet qasje në sistemin e kanalizimeve dhe të higjienës të përshtatshme dhe të barabartë për të gjithë dhe t’i jepet fund jashtëqitjeve në hapësira të hapura, duke i kushtuar vëmendje të veçantë nevojave të grave dhe vajzave dhe personave që janë në gjendje të pambrojtur.

6.3 Deri në vitin 2030, të përmirësohet cilësia e ujit duke zvogëluar ndotjen, duke eliminuar hedhjen e mbetjeve jashtë vendit të përcaktuar dhe duke minimizuar shkarkimin e kimikateve dhe të materialeve të tjera të rrezikshme, duke përgjysmuar përqindjen e sasisë së ujërave të zeza të patrajtuara dhe duke rritur ndjeshëm riciklimin dhe ripërdorimin e sigurt në nivel global.

6.4 Deri në vitin 2030, të rritet ndjeshëm përdorimi efikas i ujit në të gjithë sektorët dhe të sigurohet tërheqja e qëndrueshme e tij dhe furnizimi me ujë të pijshëm për të adresuar mungesën e ujit dhe për të zvogëluar ndjeshëm numrin e njerëzve që vuajnë nga mungesa e ujit.

6.5 Deri në vitin 2030, të zbatohet menaxhimi i integruar i burimeve ujore në të gjitha nivelet, përfshirë edhe përmes bashkëpunimit ndërkufitar sipas rastit.

6.6 Deri në vitin 2020, të mbrohen dhe të rigjenerohen ekosistemet ujore, përfshirë dhe malet, pyjet, luginat, lumenjtë, ujërat nëntokësorë dhe liqenet.

6.b Të mbështetet dhe të forcohet pjesëmarrja e komuniteteve vendore në përmirësimin e menaxhimit të ujit dhe të kanalizimeve.

Sipas kornizës ligjore Komunitat janë organi përgjegjës për përmbushjen e të gjitha synimeve të renditura më lartë. Gjithësesi në praktikë ndërmarrjet publike të ujësjellësit ku në shumicën e rasteve operojnë në nivel regional, të cilat menaxhohen nga niveli qendror, luajnë rol shumë të rëndësishëm në furnizimin dhe menaxhimin e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit.

PZHK integron pjesërisht qëllimin e gjashtë, me fokus në përmirësimin e qasjes në ujë të pijëshëm dhe kanalizim, dhe mbrojtjes së ekosistemeve ujore.

Kjo kornizë përfshinë tri nga shtatë synimet e QZHQ-ve relevante për nivelin lokal, ndërsa nuk adreson synimet 6.3, 6.4, 6.5 dhe 6.b.

Synimi 6.1 i QZHQ-ve adresohet nga tri qellime të PZHK-së dhe tri synime përkatëse:

QËLLIMI 1: Zhvillim ekonomik i qëndrueshëm dhe rritje e punësimit në një qytet tërheqës dhe kreativ

Synimi 1.4 Përmirësimi i efikasitetit të sektorit publik në furnizimin e shërbimeve për qytetarët dhe bizneset;

QËLLIMI 3 Qytetarëve t'u sigurohet një sistem efektiv dhe cilësor i shërbimeve publike dhe një mjedis i rehatshëm urban

Synimi 3.5 Të ofrohet infrastrukturë e përshtatshme për shëndet dhe higjienë nëpër qytet dhe fshatra (furnizim me ujë, hedhja e mbeturinave, energjia, menaxhimi i mbeturinave, zona të gjelbërta).

QËLLIMI 6 Zhvillimi rural dhe ruajtja e trashëgimisë natyrore

Synimi 6.3 Zhvillimi i infrastrukturës rrugore dhe ofrimi i shërbimeve publike në zonat rurale, duke i shërbyer edhe zhvillimit të turizmit në peizazhin e bukur të Kosovës;

Synimi 6.2 i QZHQ-ve adresohet nga dy qëllime të PZHK-së dhe dy synime përkatëse:

QËLLIMI 1: Zhvillim ekonomik i qëndrueshëm dhe rritje e punësimit në një qytet tërheqës dhe kreativ

Synimi 1.4 Përmirësimi i efikasitetit të sektorit publik në furnizimin e shërbimeve për qytetarët dhe bizneset;

QËLLIMI 6 Zhvillimi rural dhe ruajtja e trashëgimisë natyrore


Synimi 6.3 Zhvillimi i infrastrukturës rrugore dhe ofrimi i shërbimeve publike në zonat rurale, duke i shërbyer edhe zhvillimit të turizmit në peizazhin e bukur të Kosovës;

Synimi 6.6 i QZHQ-ve adresohet nga një qëllim i PZHK-së dhe një synim përkatës:

QËLLIMI 6 Zhvillimi rural dhe ruajtja e trashëgimisë natyrore

Synimi 6.5 Ruajtja e biodiversitetit: zhvillimi i rrjetit ekologjik brenda në qytet; zhvillimi i zonave të gjelbërta, të pasura me biotope.

PZHK synon shtrirjen e rrjetit të ujit në qytete dhe fshatra, mirëpo nuk specifikon nëse si i tillë ky shërbim duhet të jetë i gjithëanshëm dhe i përbalueshëm për të gjithë. Edhe pse PZHK përmes Qëllimit 6 synon ofrimin e shërbimeve publike, nuk specifikon rrjetin e kanalizimit. Si i tillë rregullimi i rrjetit të kanalizimit adresohet në kuadër të veprimeve të prioritetit strategjik nr.6 Përmirësimi i cilësisë së mjedisit urban dhe rural.



E synimeve relevante të Qëllimit 6 kanë pajtueshmeri të plotë dhe të pjesëshme me synimet e PZHK-së

7 ENERGJI E PËRBALLUESHME DHE E PASTËR



Ky qëllim ka të bëjë me sigurimin e qasjes për të gjithë në energji të ripërtëritshme, me ndjeshmëri të madhe ndaj mbrojtjes së mjedisit

Synimet relevante të qëllimit 7 “Sigurimi i lidhjes me energji të përballueshme, të sigurt, të qëndrueshme dhe moderne për të gjithë” për nivelin lokal janë:

7.1 Deri në vitin 2030, të sigurohet qasje e përgjithshme në shërbime të përballueshme, të besueshme dhe moderne të energjisë.

7.2 Deri në vitin 2030, të rritet ndjeshëm pjesa që zë energjia e rinovueshme në totalin e energjisë së përftuar nga burime të ndryshme në nivel global.

7.3 Deri në vitin 2030, të dyfishohet norma globale e përmirësimit të eficiencës së energjisë.

Komuna nuk ka kompetenca direkte në përmirësimin e qasjes në energji të përballueshme, kontribuon në identifikimin e sfidave, në krijimin e mjedisit të përshtatshëm për investim në teknologji moderne në fushën e energjisë dhe koordinimin me institucionin përkatës për shtrirjen dhe menaxhimin e rrjetit të energjisë.

Qëllimet dhe synimet e PZHK-së adresojnë Qëllimin e shtatë të QZHQ-ve pjesërisht.

Edhe pse kjo komponentë nuk është integruar në mënyrë specifike në kuadër të qëllimeve dhe synimeve të PZHK-së, të gjitha synimet relevante të QZHQ-ve janë adresuar përmes prioriteteve strategjike komunale dhe veprimeve përkatëse si:



E synimeve relevante të Qëllimit 7 janë adresuar në kuadër të prioriteteve strategjike të PZHK-së

S5: Rritja e modeleve të vendbanimeve rurale për një zhvillim të ri të bujqësisë, përkatësisht veprimit Përmirësimi i furnizimit me ujë, hedhjes së mbeturinave, energjisë elektrike dhe shërbimeve të tjera nëpër fshatra

S6: Përmirësimi i cilësisë së mjedisit urban dhe rural, , përktësisht veprimit *Përpunimi i një programi të energjisë në nivel vendor për të promovuar ruajtjen e energjisë dhe përdorimin e burimeve të qëndrueshme, duke pakësuar humbjet nëpërmjet linjave me furnizim të dobët*

S7: Nxitja e aktivizimit të ndërmarrjeve të reja, përktësisht veprimit *Përmirësimi i kabllave elektrike dhe komunikimit digjital.*

8 PUNË DINJITOE DHE RRIJTJE EKONOMIKE



Ky qëllim ka të bëjë me krijimin e vendeve të denja të punës dhe mundësive ekonomike për të gjithë

Synimet relevante të qëllimit 8 “Nxitja e rritjes ekonomike të vazhdueshme, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, punësim të plotë dhe produktiv dhe punë të denjë për të gjithë” per nivelin lokal janë:

8.3 Të përkrahen politika të orientuara në zhvillim, që mbështetin aktivitetet prodhuese, krijimin e vendeve të denja të punës, sipërmarrjen, krijimtarinë dhe risitë dhe të nxitet formalizmi dhe rritja e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, përfshirë edhe qasjes tek shërbimet financiare.

8.5 Deri në vitin 2030, të arrihet punësimi i plotë dhe produktiv dhe punë të denja për të gjithë gratë dhe burrat, përfshirë të rinjtë dhe personat me aftësi të kufizuar, si dhe pagesë të barabartë për punën me vlerë të njëjtë.

8.6 Deri në vitin 2020, të zvogëlohet ndjeshëm përqindja e të rinjve të papunë, të paarsimuar apo të patrajnuar.

8.7 Të merren masa të menjëhershme dhe efektive për të çrrënjësuar punën e detyruar, për t’i dhënë fund skllavërisë moderne dhe trafikimit të qenieve njerëzore dhe të sigurohet ndalimi dhe eliminimi i formave më të këqija të punës së fëmijëve, përfshirë rekrutimin dhe përdorimin e fëmijëve si ushtarë, dhe deri në vitin 2025 t’i jepet fund punës së fëmijëve në të gjitha format e saj.

8.8 Të mbrohen të drejtat për punë dhe të mundësohen mjedise pune të sigurta për të gjithë punëtorët, përfshirë punëtorët emigrantë, e në veçanti gratë emigrante, dhe ata që punojnë në punë jo të sigurta.

8.9 Deri në vitin 2030, të hartohen dhe të zbatohen politika për nxitjen e turizmit të qëndrueshëm, që krijon vende pune dhe përkrah kulturën dhe produktet vendase.

Komuna është kompetente për zhvillimin ekonomik lokal, politikat lokale dhe masat për nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm duke përfshirë turizmin si nj nga sektorët. Ky rol e bënë komunën përgjegjës në përmbushjen e synimit 8.3 dhe 8.9.

Qëllimi i tetë është i integruar pjesërisht në kuadër të kornizës së PZHK-së, meqë nuk adreson tri nga synimet si 8.5, 8.7, dhe 8.8.

Synimi 8.3 i QZHQ-ve adresohet nga një qëllimi të PZHK-së dhe tri synime përkatëse:

QËLLIMI 1: Zhvillim ekonomik i qëndrueshëm dhe rritje e punësimit në një qytet tërheqës dhe kreativ

Synimi 1.2 Krijimi i kushteve për të tërhequr kapitalin/investimet e huaja

Synimi 1.3. Themelimi i parqeve të biznesit dhe zonave industriale; zhvillimi i një nyjelloreje për mallra (HUB)

Synimi 1.4 Përmirësimi i efikasitetit të sektorit publik në furnizimin e shërbimeve për qytetarët dhe bizneset;

Synimi 1.5 Zhvillimi i projekteve të mëdha të investimeve nëpërmjet partneritetit publiko-privat.

Synimi 8.6 i QZHQ-ve adresohet nga një qëllim i PZHK-së dhe një synim përkatës:

QËLLIMI 2 : Prishtina në rrjetet botërore

Synimi 2.2 Krijimi i kushteve dhe mjeteve kulturore që kërkohen, e po ashtu i një edukimi që u mundëson të rinjve që t'i rrisin njohuritë e tyre drejt një standardi botëror, duke u bërë kështu konkurrencë kolegëve të tyre në Evropë dhe në botë (Prishtina drejt "smart city", krijimi i zonave të lira të internetit etj.);

Synimi 8.9 i QZHQ-ve adresohet nga dy qëllime të PZHK-së dhe pesë synime përkatëse:

QËLLIMI 5 Forcimi i identitetit duke vlerësuar peisazhin historik dhe kulturor

Synimi 5.2 Promovimi dhe zhvillimi i formave të ndryshme të turizmit: turizmi arkeologjik, eko-turizmi ose turizmi i gjelbër, duke shfrytëzuar natyrën dhe peizazhin e bukur; turizmi kulturor i kombinuar me turizmin rural;

Synimi 5.3 Zgjerimi i atraksioneve turistike (të kualifikohen muzetë, etj);

Synimi 5.4 Mirëmbajtja dhe krijimi i infrastrukturës turistike;

QËLLIMI 6 Zhvillimi rural dhe ruajtja e trashëgimisë natyrore

Synimi 6.3 Zhvillimi i infrastrukturës rrugore dhe ofrimi i shërbimeve publike në zonat rurale, duke i shërbyer edhe zhvillimit të turizmit në peizazhin e bukur të Kosovës;

Synimi 6.4 Zhvillimi i një parku të madh natyror për rekreacion dhe aktivitete për argëtim;

PZHK integron politika që promovojnë zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm, mirëpo nuk adreson në mënyrë specifike krijimin e vendeve të punës. Kjo kornizë synon fuqizim të kapaciteteve tek të rinjtë, mirëpo ndryshe nga QZHQ-të që targeton statusin e punës apo edukimit në mënyrë specifike, PZHK fokusohet në krijimin e kushteve për thithjen e informatës/ dijes tek të rinjtë që të jenë sa më konkurues në tregun ndërkombëtar.



E synimeve relevante të Qëllimit 8 kanë pajtueshmeri të plotë dhe të pjesëshme me synimet e PZHK-së

9 INDUSTRI, INOVACION DHE INFRASTRUKTURË



Ky qëllim ka të bëjë me sigurimin e infrastrukturës për ndërlidhjen e çdonjërit me pjesën tjetër të botës

Synimet relevante të qëllimit 7 “Ndërtimi i infrastrukturës rezistente, nxitja e industrializimit gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm dhe nxitja e Inovacionit” per nivelin lokal janë:

9.1 Të zhvillohet një infrastrukturë cilësore, e sigurt, e qëndrueshme dhe rezistente, përfshirë infrastrukturën rajonale dhe ndërkufitare, për të mbështetur zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien e njerëzve, me fokus qasjen e përballueshme dhe të barabartë për të gjithë.

9.3 Të rritet qasja e ndërmarrjeve të vogla industriale dhe e ndërmarrjeve të tjera, në veçanti në vendet në zhvillim, tek shërbimet financiare, duke përfshirë kredi të përballueshme, dhe integrimi i tyre në zinxhirët e vlerave dhe të tregjeve.

9.c Të rritet në mënyrë të konsiderueshme qasje në teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit dhe përpjekjet për të siguruar një qasje të gjithëanshme dhe të përballueshme në internet në vendet më pak të zhvilluara, deri në vitin 2020.

Komuna është përgjegjësi kryesor në përmbushjen e synimit 9.1 , përkatësisht rrugëve lokale.

Korniza e PZHK-së integron pjesërisht të gjitha synimet e qëllimit të 9 të QZHQ-ve, përmes pesë qëllimeve të dhe shtatë synimeve përkatëse.

Synimi 9.1 i QZHQ-ve adresohet nga tri qëllime të PZHK-së dhe shtatë synime përkatëse:

QËLLIMI 1: Zhvillim ekonomik i qëndrueshëm dhe rritje e punësimit në një qytet tërheqës dhe kreativ

Synimi 1.2 Krijimi i kushteve për të tërhequr kapitalin/investimet e huaja

Synimi 1.4 Përmirësimi i efikasitetit të sektorit publik në furnizimin e shërbimeve për qytetarët dhe bizneset;

QËLLIMI 2 : Prishtina në rrjetet botërore

Synimi 2.1 Rritja e qasjes në rrjetet ndërkombëtare të transportit (lidhje me korridoret evropiane, duke pasur si qëllim lidhjen veçanërisht me korridoret V, VI, VIII, dhe X);

QËLLIMI 4 Zhvendosja e njerëzve dhe mallrave në mënyrë efikase dhe të qëndrueshme

Synimi 4.1 Krijimi dhe kompletimi i një sistemi efektiv të komunikacionit, për qytetin dhe Zonën e gjerë urbane, mënjanimi i komunikacionit tranzit; implementimi i tri “unazave” për organizimin e sistemit të transportit;

Synimi 4.3 Mirëmbajtja e vazhdueshme dhe përmirësimi i sistemit të rrugëve të vjetra, në përputhshmëri me standardet në bazë të klasifikimit hierarkik dhe ndërtimi i atyre të reja për një transport më efektiv (sidomos në zonat rurale);

Synimi 4.5 Ruajtja dhe forcimi i linjave hekurudhore (apo tramvajet) me polaritete të ndryshme urbane (aeroporti, stacioni i autobusëve, qendra e qytetit, etj.).

Synimi 4.7 Organizimi i transportit të mallrave brenda qytetit (kufizon kohën e qasjes, më pak shkarkime të automjeteve etj.).

Synimi 9.2 i QZHQ-ve adresohet nga një qëllim i PZHK-së dhe një synim përkatës:

QËLLIMI 6 Zhvillimi rural dhe ruajtja e trashëgimisë natyrore

Synimi 6.1 Vlerësimi i tokës pjellore bujqësore (përdorimi efikas i tokës bujqësore dhe mbështetja për produktivitet ekologjik, multi-funksionalitetit, tregut të fermerëve, shërbimet e sigurta për fshatrat rurale);

Synimi 9.c i QZHQ-ve adresohet nga një qëllim i PZHK-së dhe një synim përkatës:

QËLLIMI 2 : Prishtina në rrjetet botërore



E synimeve relevante të Qëllimit 9 kanë pajtuesmeri të plotë dhe të pjesëshme me synimet e PZHK-së

Synimi 2.2 Krijimi i kushteve dhe mjeteve kulturore që kërkohen, e po ashtu i një edukimi që u mundëson të rinjve që t'i rrisin njohuritë e tyre drejt një standardi botëror, duke u bërë kështu konkurrencë kolegëve të tyre në Evropë dhe në botë (Prishtina drejt "smart city", krijimi i zonave të lira të internetit etj.);

PZHK adreson në masë të madhe komponent të synimeve 9.1, 9.2 dhe 9.3., mirëpo nuk adreson në mënyrë specifike gjithëpërfshirjen dhe qasjen e përbalueshme për të gjithë. Në rastin e synimit 9.3, PZHK adreson zhvillimin e infrastrukturës që kontribuon në fuqizimin e zingjirit të vlerës mirëpo nuk trajton specifikisht aspektin që ky synim përfaqëson. Sa i përket synimit 9.c PZHK-ja e integron si një nga aktivitetet për krijimin e zonave të lira të internetit, në mënyrë që t'u mundësoj të rinjve qasjen në informatë.

11 QYTETE DHE KOMUNITETE TE QËNDRUESHME



Ky qëllim ka të bëjë me rolin kyq të qytetit në zhvillim të qëndrueshëm në një botë të urbanizuar

Qëllimi 11 “Ndërtimi i qyteteve dhe i vendbanimeve gjithëpërfshirës, të sigurt, rezistentë dhe të qëndrueshëm” i dedikohet nivelit lokal, qyteteve/ vendbanimeve, dhe përmbanë këto synime:

11.1 Deri në vitin 2030, të sigurohet për të gjithë njerëzit qasje për strehim të përshtatshëm, të sigurt dhe të përballueshëm dhe në shërbime bazë dhe të përmirësohet situata në lagjet e varfëra.

11.2 Deri në vitin 2030, të sigurohet për të gjithë qasje në sistemet e transportit të sigurt, të përballueshëm, të

arritshëm dhe të qëndrueshëm, duke përmirësuar sigurinë rrugore, sidomos duke zgjeruar shërbimin e transportit publik, me vëmendje të veçantë ndaj nevojave të personave në gjendje të pambrojtur, grave, fëmijëve, personave me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit.

11.3 Deri në vitin 2030, të zgjerohet urbanizimi në nivel gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm dhe të forcohen kapacitetet për planifikimin dhe menaxhimin e vendbanimeve të qëndrueshme, përfshirëse dhe pjesëmarrëse, në të gjitha vendet.

11.4 Të forcohen përpjekjet për të mbrojtur dhe për të ruajtur trashëgiminë kulturore dhe natyrore të botës.

11.5 Deri në vitin 2030, të zvogëlohet ndjeshëm numri i vdekjeve dhe numri i njerëzve të prekur nga fatkeqësitë dhe të ulen ndjeshëm humbjet ekonomike të drejtpërdrejta, lidhur me prodhimin e brendshëm bruto në nivel global, të shkaktuara nga fatkeqësitë, përfshirë dhe fatkeqësitë që lidhen me ujin, me fokus mbrojtjen e shtresave të varfëra dhe të njerëzve në gjendje të pambrojtur.

11.6 Deri në vitin 2030, të zvogëlohet ndikimi negativ në mjedis për frymë i qyteteve, duke i kushtuar vëmendje të veçantë cilësisë së ajrit, menaxhimit të mbetjeve bashkiake dhe mbetjeve të tjera.


11.7 Deri në vitin 2030, të sigurohet qasje e gjithëanshme në hapësirat publike të gjelbra, të sigurta, gjithëpërfshirëse dhe të arritshme, në veçanti për gratë dhe fëmijët, të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara.

11.a Të mbështeten lidhjet pozitive ekonomike, sociale dhe mjedisore ndërmjet zonave urbane, ndër-urbane dhe rurale duke forcuar planifikimin për zhvillim në nivel kombëtar dhe rajonal.

Komunat, qeverisja lokale, janë organi kompetent për përmbushjen e qëllimit 11 në tërësi, duke integruar në plotni synimet në politikat lokale, zbrërthimit të tyre në projekte kapitale dhe programeve për ofrim të shërbimeve, si dhe ndërtimin e partneriteteve të nevojshme për monitorim dhe raportim rreth progresit në përmbushjen e tyre.

PZHK integron në masë të madhe Qëllimin e njëmbëdhjetë, duke përfshirë sektorin e banimit, infrastrukturën rrugore dhe transportin publik, menaxhimin e vendbanimeve, trashëgiminë kulturore dhe natyrore, zvoglimit të ndotjes së mjedisit dhe hapësirat publike.

PZHK-ja integron gjashtë nga tetë synimet e QZHQ-ve, prej të cilave 11.4 përkatësisht mbrojtja e trashëgimisë kulturore është adresuar në plotni.



E synimeve të Qëllimit 11 kanë pajtueshmeri të plotë dhe të pjesëshme me synimet e PZHK-së

Synimi 11.1 i QZHQ-ve adresohet nga katër qëllime të PZHK-së dhe katër synime përkatëse:

QËLLIMI 1: Zhvillim ekonomik i qëndrueshëm dhe rritje e punësimit në një qytet tërheqës dhe kreativ

Synimi 1.4 Përmirësimi i efikasitetit të sektorit publik në furnizimin e shërbimeve për qytetarët dhe bizneset;

QËLLIMI 3 Qytetarëve t'u sigurohet një sistem efektiv dhe cilësor i shërbimeve publike dhe një mjedis i rehatshëm urban

Synimi 3.5 Të ofrohet infrastrukturë e përshtatshme për shëndet dhe higjienë nëpër qytet dhe fshatra (furnizim me ujë, hedhja e mbeturinave, energjia, menaxhimi i mbeturinave, zona të gjelbërta).

QËLLIMI 6 Zhvillimi rural dhe ruajtja e trashëgimisë natyrore

Synimi 6.3 Zhvillimi i infrastrukturës rrugore dhe ofrimi i shërbimeve publike në zonat rurale, duke i shërbyer edhe zhvillimit të turizmit në peizazhin e bukur të Kosovës;

QËLLIMI 7 Drejt një modeli të ri të zhvillimit hapësinor urban

Synimi 7.2 Shmangia e shpërndarjes urbane, të ndalohen ndërtimet e paligjshme dhe të përkrahet zhvillimi i rregullt i qytetit 15;

Synimi 11.2 i QZHQ-ve adresohet nga një qëllim i PZHK-së dhe një synim përkatës:

QËLLIMI 4 Zhvendosja e njerëzve dhe mallrave në mënyrë efikase dhe të qëndrueshme

Synimi 4.4 Zhvillimi i rregullt dhe i besueshëm i linjave të transportit publik, duke përfshirë linja të reja të lehta të transportit hekurudhor dhe modernizimi i mjeteve të transportit publik;

Synimi 11.3 i QZHQ-ve adresohet nga një qëllim i PZHK-së dhe katër synime përkatëse:

QËLLIMI 7 Drejt një modeli të ri të zhvillimit hapësinor urban

Synimi 7.2 Shmangia e shpërndarjes urbane, të ndalohen ndërtimet e paligjshme dhe të përkrahet zhvillimi i rregullt i qytetit 15;

Synimi 7.3. Fillimi i një procesi të plotë të renovimit (apo rregullimit) urban të qytetit ekzistues;

Synimi 7.4 Në lidhje me zhvillimin dhe rregullimin urban; Promovimi i partneritetit publik dhe privat; organizatave joqeveritare të specializuara në banim; stimulimi i bashkëpunimit në mes grupeve të njerëzve në pritje të ndërtimit të shtëpive të tyre;

Synimi 7.5 Themelimi i institucionit të planifikimit nga Komuna e Prishtinës dhe plotësimi i planeve të bazuara në ligje; themelimi i një mekanizmit efektiv të administrimit urban.

Synimi 11.4 i QZHQ-ve adresohet nga dy qëllime të PZHK-së dhe dy synime përkatëse:

QËLLIMI 5 Forcimi i identitetit duke vlerësuar peizazhin historik dhe kulturor

Synimi 5.1 Vlerësimi i trashëgimisë historike (Hartimi i planeve rregulluese për qendrën e qytetit dhe zonën historike; rehabilitimi i objekteve fetare dhe historike, etj);

QËLLIMI 6 Zhvillimi rural dhe ruajtja e trashëgimisë natyrore

Synimi 6.5 Ruajtja e biodiversitetit: zhvillimi i rrjetit ekologjik brenda në qytet; zhvillimi i zonave të gjelbërta, të pasura me biotope.

Synimi 11.6 i QZHQ-ve adresohet nga tri qëllime të PZHK-së dhe tri synime përkatëse:

QËLLIMI 1: Zhvillim ekonomik i qëndrueshëm dhe rritje e punësimit në një qytet tërheqës dhe kreativ

Synimi 1.4 Përmirësimi i efikasitetit të sektorit publik në furnizimin e shërbimeve për qytetarët dhe bizneset;

QËLLIMI 3: Qytetarëve t'u sigurohet një sistem efektiv dhe cilësor i shërbimeve publike dhe një mjedis i rehatshëm urban

3.5 Të ofrohet infrastrukturë e përshtatshme për shëndet dhe higjienë nëpër qytet dhe fshatra (furnizim me ujë, hedhja e mbeturinave, energjia, menaxhimi i mbeturinave, zona të gjelbërta).

QËLLIMI 6 :Zhvillimi rural dhe ruajtja e trashëgimisë natyrore

Synimi 6.3 Zhvillimi i infrastrukturës rrugore dhe ofrimi i shërbimeve publike në zonat rurale, duke i shërbyer edhe zhvillimit të turizmit në peizazhin e bukur të Kosovës;

Synimi 11.7 i QZHQ-ve adresohet nga katër qëllime të PZHK-së dhe gjashtë synime përkatëse:

QËLLIMI 4 Zhvendosja e njerëzve dhe mallrave në mënyrë efikase dhe të qëndrueshme

Synimi 4.1 Krijimi dhe kompletimi i një sistemi efektiv të komunikacionit, për qytetin dhe Zonën e gjerë urbane, mënjanimi i komunikacionit tranzit; implementimi i tri “unazave” për organizimin e sistemit të transportit;

Synimi 4.3 Mirëmbajtja e vazhdueshme dhe përmirësimi i sistemit të rrugëve të vjetra, në përputhshmëri me standardet në bazë të klasifikimit hierarkik dhe ndërtimi i atyre të reja për një transport më efektiv (sidomos në zonat rurale);

Synimi 4.6 Zhvillimi i një rrjeti për shtigje të çiklistëve, përmirësimin e sigurisë së këmbësorëve dhe rrugëve me pengesë të lirë;

QËLLIMI 6 Zhvillimi rural dhe ruajtja e trashëgimisë natyrore

Synimi 6.4 Zhvillimi i një parku të madh natyror për rekreacion dhe aktivitete për argëtim;

Sa i përket synimit 11.1 PZHK nuk integron sigurimin e strehimit. Edhe pse ofrimi i shërbimeve publike adresohet nga 3 synime të PZHK-së, përcakton qytetarët, bizneset apo zonat rurale në mënyrë më të përgjithshme si grupe të synuara përfituese, ndërsa nuk adreson lagjet e varfëra apo grupe më të cënuara. PZHK ka pajtushmëri të plotë me synimin 11.2 sa i përket aspektit dhe cakut në raport me zhvillimin e transportit, mirëpo nuk përcakton grupe të synuaranë mënyrë specifike.

Për dallim nga synimi 11.3, PZHK synon zhvillimin e qëndrueshëm të vendbanimeve dhe parasheh masa për fuqizimin e kapaciteteve për planifikim dhe menaxhim të vendbanimeve, mirëpo nuk definon në mënyrë eksplicite pjesëmarrjen gjithëpërfshirëse në procese të tilla.

Synimi 11.4 i QZHQ-ve, është integruar në plotni meqë PZHK parasheh masa për të mbrojtur trashëgiminë kulturore si në nivelin e politikave ashtu edhe në ndërmarrjen e veprimeve konkrete.

Korniza e PZHK-së integron pjesërisht synimin 11.7, meqë synon rregullimin e një parku të madh natyror dhe rrjetin e mobilitetit, mirëpo nuk adreson hapësirën publike në plotni si rrjet në kuadër të qytetit.

12 KONSUM DHE PRODHIM I PËRGJEGJSHËM



Ky qëllim ka të bëjë me zvogëlimin e ndikimit tonë në planet duke prodhuar dhe konsumuar vetëm çka kemi nevojë

Synimet relevante të qëllimit 12 “Sigurimi i modeleve të qëndrueshme të konsumit dhe të prodhimit” për nivelin lokal janë:

- 12.2 Deri në vitin 2030, të arrihet menaxhimi i qëndrueshëm dhe përdorimi eficient i burimeve natyrore.*
- 12.3 Deri në vitin 2030, të përgjysmohen mbetjet ushqimore për frymë në nivel global, për të arritur në nivelet e shitjes me pakicë dhe të konsumatorit dhe të zvogëlohen humbjet e ushqimit përgjatë zinxhirëve të prodhimit dhe të furnizimit, duke përfshirë dhe humbjet pas korrijeve.*
- 12.4 Deri në vitin 2020, të arrihet menaxhimi i shëndetshëm mjedisor i kimikateve dhe i të gjitha mbetjeve gjatë ciklit të tyre të jetës, në përputhje me kornizat kuadër ndërkombëtare të miratuara, dhe të zvogëlohet ndjeshëm shkarkimi i tyre në ajër, ujë dhe tokë, me qëllim zvogëlimin e ndikimeve negative mbi shëndetin e njeriut dhe mjedisin.*
- 12.5 Deri në vitin 2030, të zvogëlohet ndjeshëm krijimi i mbetjeve përmes zbatimit të parimeve të parandalimit, reduktimit, riciklimit dhe të ripërdorimit.*
- 12.7 Të përkrahen praktika të prokurimit publik që janë të qëndrueshme, në përputhje me politikat dhe prioritetet kombëtare.*
- 12.8 Deri në vitin 2030, të sigurohet që njerëzit të marrin informacionin e duhur dhe të ndërgjegjësohen për Zhvillimin e Qëndrueshëm dhe mënyrën e jetesës në harmoni me natyrën.*
- 12.a Të mbështeten vendet në zhvillim për të forcuar kapacitetet e tyre shkencore dhe teknologjike drejt modeleve më të qëndrueshme të konsumit dhe të prodhimit.*
- 12.b Të zhvillohen dhe të zbatohen mjetet për të monitoruar ndikimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm për turizëm të qëndrueshëm, duke krijuar vende pune dhe përkrahur kulturën dhe prodhimet vendase.*

Komuna është kompetente për ofrimin e infrastrukturës së nevojshme publike dhe inspektim që të siguroj menaxhim dhe mbrojtje të mirëfillt të burimeve natyrore, të promovoj dhe zbatoj modele të qëndrueshme të menaxhimit të mbeturinave, ndërgjegjësimin dhe edukimin e opinionit, rol i cili e bënë kontribues kyç në përmbushjen e synimit 12.2, 12.4, 12.5, 12.7, 12.8 dhe 12.b.

PZHK integron pjesërisht qëllimin e dymbëdhjetë, kryesisht sa i përket menaxhimit dhe shfrytëzimit eficient të burimeve natyrore, krijimi i kushteve për plasim të produkteve lokale ushqimore dhe zvogëlimin të ndotjes së ajrit, ujit dhe tokës.

PZHK integron tri nga tetë synimet relevante të QZHQ-ve për nivelin lokal, synimin 12.2, 12.3 dhe 12.5.



E synimeve të Qëllimit 12 kanë pajtueshmeri të plotë dhe të pjesëshme me synimet e PZHK-së

Synimi 12.2 dhe 12.3 i QZHQ-ve adresohet nga një qëllim i PZHK-së dhe një synim përkatës:

QËLLIMI 6 Zhvillimi rural dhe ruajtja e trashëgimisë natyrore

Synimi 6.1 Vlerësimi i tokës pjellore bujqësore (përdorimi efikas i tokës bujqësore dhe mbështetja për produktivitet ekologjik, multi-funksionalitetit, tregut të fermerëve, shërbimet e sigurta për fshatrat rurale);

PZHK synon në mënyrë specifike shfrytëzimin efikas të tokës bujqësore, përderisa nuk adreson burimet e tjera natyrore. Poashtu, në mënyrë eksplicite numëron disa nga masat që Komuna duhet të ndërmarrë në promovimin e zingjirit të prodhimit dhe furnizimit si p.sh. tregun e fermerëve apo shërbimet e sigurta për fshatrat rurale,, mirëpo nuk integron të gjitha komponentet e ciklit në menaxhimin e produkteve bujqësore para arritjes në nivelin e shitjes me pakicë.

Edhe pse qëllimet dhe synimet e PZHK-së nuk adresojnë në mënyrë specifike masa apo praktika si në synimin 12.4 përkatësisht zvogëlimi i mbetjeve përmes parandalimit, reduktimit, riciklimit dhe ripërdorimit, në kuadër të prioritetit strategjik 6 , PZHK obligon komunën t'i ofroj mbështetje bizneseve të përfshira në riciklim apo ripërdorim të produkteve.

15 JETA NË STERE



Ky qëllim ka të bëjë me mbrojtjen e burimeve natyrore dhe kafshët e egra

Synimet relevante të qëllimit 15 “Mbrojtja, rehabilitimi dhe promovimi i përdorimit të qëndrueshëm të ekosistemeve tokësore, menaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve, lufta kundër shkretëtirëzimit, ndalimi e kthimi mbrapa i procesit të degradimit të tokës dhe ndalimi i humbjes së biodiversitetit” per nivelin lokal janë:

15.1 Deri në vitin 2020, të sigurohet ruajtja, restaurimi dhe përdorimi i qëndrueshëm i ekosistemeve tokësore dhe i ekosistemeve të ujërave të ëmbla dhe shërbimet e tyre, veçanërisht pyjet, ligatinat, malet dhe tokat e thata, në përputhje me detyrimet sipas marrëveshjeve ndërkombëtare.

15.2 Deri në vitin 2020, të promovohet zbatimi i menaxhimit të qëndrueshëm i të gjitha llojeve të pyjeve, ndalimi i shpyllëzimit, rehabilitimi i pyjeve të degraduar dhe rritja e qëndrueshme e pyllëzimit dhe ripyllëzimi në nivel global.

15.3 Deri në vitin 2030, të luftohet shkretëtirëzimi, rehabilitimi i tokës së degraduar, përfshirë dhe tokën e prekur nga shkretëtirëzimi, thatësira dhe përmbytjet, dhe të synohet ndalimi i degradimit të tokës.

15.5 Të ndërmerren masa urgjente dhe të rëndësishme për të zvogëluar degradimin e habitateve natyrore, ndalimin e humbjes së biodiversitetit dhe, deri në vitin 2020, të mbrohet dhe të parandalohet zhdukja e llojeve të kërcënuar.

15.9 Deri në vitin 2020, të përfshihen vlerat e ekosistemit dhe të biodiversitetit në planifikimin kombëtar dhe vendor, në proceset e zhvillimit, në strategjitë dhe raportimet për uljen e varfërisë.

15.b Të aktivizohen fonde të rëndësishme nga të gjitha burimet dhe në të gjitha nivelet për të financuar menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe për të ofruar stimujt e përshtatshëm për vendet në zhvillim për të ecur përpara në menaxhim, përfshirë dhe ruajtjen e ripyllëzimin.

Komuna, përmes kompetencave të deleguara mund të kontriboj në përmbushjen e synimeve të listuara më lartë, të cilat kanë për qëllim mbrojtjen e pyjeve dhe ekosistemeve përkatëse. Përveç synimit 15.9, të cilin komuna e përmbushë duke integruar qështjet mjedisore në politikat lokale përkatëse.

Qëllimi I pesëmbëdhjetë është integruar pjesërisht në kuadër të kornizës së PZHK-së, me fokus në zhvillimin e politikave të ndjeshme ndaj mjedisit dhe masa për mbrojtjen e burimeve natyrore.

Korniza e PZHK-së integron tri nga gjashtë synimet relevante të qëllimit të pesëmbëdhjetë, ndërsa nuk adreson synimin 15.3 rreth parandalimit dhe rehabilitimit të tokës së degraduar, 15.9 rreth integritetit të vlerave të ekosistemit në politika lokale dhe 15.b rreth mobilizimit të fondeve për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve.



E synimeve relevante të Qëllimit 15 kanë pajtueshmeri të pjesëshme me synimet e PZHK-së

Synimi 15.1 i QZHQ-ve adresohet nga një qëllim i PZHK-së dhe dy synime përkatëse:

QËLLIMI 6 Zhvillimi rural dhe ruajtja e trashëgimisë natyrore

Synimi 6.5 Ruajtja e biodiversitetit: zhvillimi i rrjetit ekologjik brenda në qytet; zhvillimi i zonave të gjelbërta, të pasura me biotope.

Synimi 6.6 Ruajtja e pyjeve, ndihmesa për qasjen dhe përdorimin rekreativ, nxitja për mirëmbajtjen e duhur.

Synimi 15.2 i QZHQ-ve adresohet nga dy qëllime të PZHK-së dhe tri synime përkatëse:

QËLLIMI 6 Zhvillimi rural dhe ruajtja e trashëgimisë natyrore

Synimi 6.6 Ruajtja e pyjeve, ndihmesa për qasjen dhe përdorimin rekreativ, nxitja për mirëmbajtjen e duhur.


Synimi 15.5 i QZHQ-ve adresohet nga një qëllim i PZHK-së dhe një synim përkatës:

QËLLIMI 6 Zhvillimi rural dhe ruajtja e trashëgimisë natyrore

Synimi 6.5 Ruajtja e biodiversitetit: zhvillimi i rrjetit ekologjik brenda në qytet; zhvillimi i zonave të gjelbërta, të pasura me biotope.

PZHK synon mbrojtjen dhe mirëmbajtjen e pyjeve, mirëpo nuk adreson në mënyrë specifike rigjenerimin përkatësisht rehabilitimin e pyjeve të degraduara dhe ripyllzimin, me çrast integron synimin 15.2 pjesërisht. Edhe pse synon ruajtjen e biodiversitetit dhe zhvillimin e rrjetit ekologjik, PZHK nuk është indikative nëse ka lloje të kërcënuara që cilat duhet të mbrohen në mënyrë specifike si specifikon synimi 15.5.

16 PAQE DHE DREJTËSI, INSTITUCIONE TË FORTA



Ky qëllim ka të bëjë me mbrojtjen e njerëzve dhe institucioneve të drejta dhe efektive

Synimet relevante të qëllimit 16 “Promovimi i shoqërive në paqe dhe gjithëpërfshirëse për një zhvillim të qëndrueshëm, siguria e qasjes në drejtësi për të gjithë, dhe ndërtimi i institucioneve gjithëpërfshirëse, llogaridhënëse efektive në të gjitha nivelet ” *per nivelin lokal janë:*

16.1 Kudo të zvogëlohen ndjeshëm të gjitha format e dhunës dhe numri i vdekjeve si rezultat i dhunës.

16.5 Të zvogëlohet ndjeshëm korrupsioni dhe rryshfeti në të gjitha format e tyre.

16.6 Të zhvillohen institucione efektive, të përgjegjshme

dhe transparente në të gjitha nivelet.

16.7 Të sigurohet vendimmarrje e përgjegjshme, gjithëpërfshirëse, pjesëmarrëse dhe përfaqësuese në të gjitha nivelet.

16.10 Të sigurohet e drejta e publikut për të marrë informacion dhe të mbrohen liritë themelore të njeriut, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe marrëveshjet ndërkombëtare.

16.b Të përkrahen dhe të forcohen ligjet dhe politikat jo diskriminuese për Zhvillim të Qëndrueshëm.

Komuna është përgjegjëse për zhvillimin e demokracisë lokale, duke ofruar qeverisje efektive, të përgjegjshme dhe transparente, përmes proceseve të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse, përkatësisht synimin 16.6 dhe 16.7.

PZHK integron integron pjesërisht një nga dy synimet e SDG-ve që përputhen me mandatin e këtij dokumenti, përkatësisht synimin 16.6 i QZHQ-ve përmes një qëllimi dhe dy synime përkatëse:

QËLLIMI 1: Zhvillim ekonomik i qëndrueshëm dhe rritje e punësimit në një qytet tërheqës dhe kreativ


Synimi 1.4 Përmirësimi i efikasitetit të sektorit publik në furnizimin e shërbimeve për qytetarët dhe bizneset;

QËLLIMI 3 Qytetarëve t'u sigurohet një sistem efektiv

dhe cilësor i shërbimeve publike dhe një mjedis i rehatshëm urban

Synimi 3.4 Të zhvillohet dhe modernizohet Administrata komunale për qytetarët;

Edhe pse PZHK synon modernizim të administratës komunale dhe sistem efikas në ofrimin e shërbimeve publike, nuk adreson në plotni synimin e QZHQ-ve, përkatësisht zhvillimi i institucioneve transparente.



E synimeve relevante të Qëllimit 16 kanë pajtueshmeri të pjesëshme me synimet e PZHK-së, ndërsa 67% e tyre nuk mbulohen nga mandati i PZHK-së

17 PARTNERITET PËR QËLLIMET



Ky qëllim ka të bëjë me ndërtimin e partneritetit ndër-institucional dhe sektorët e tjerë për përmbushjen e QZHQ-ve

Synimet relevante të qëllimit 17 “Fuqizimi i mjeteve të zbatimit dhe të rigjallërimit të partneritetit global për një zhvillim të qëndrueshëm” për nivelin lokal janë:

17.1 Të forcohet aktivizimi i burimeve të brendshme, përfshirë edhe përmes mbështetjes

17.14 Të rritet bashkëpunimi politik për Zhvillimin e Qëndrueshëm.

17.16 Të rritet partneriteti global për Zhvillimin e Qëndrueshëm, plotësuar nga një partneritet shumëpalësh që aktivizon dhe shkëmben njohuri, ekspertizë, teknologji dhe burime financiare, për të mbështetur arritjen e objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm në të gjitha vendet, e në veçanti në vendet në zhvillim.

17.17 Të nxitet dhe të përkrahet partneriteti publik efektiv, partneriteti publik-privat dhe partneriteti i shoqërisë civile, i ngritur mbi përvojën, burimet dhe strategjitë e partneritetit.

17.18 Deri në vitin 2020, të forcohet mbështetja për ngritjen e kapaciteteve në vendet në zhvillim, përfshirë edhe vendet më pak të zhvilluara dhe shtetet-ishuj të vegjël në zhvillim, për të rritur ndjeshëm disponueshmërinë e të dhënave cilësore, të përditësuara dhe të besueshme të ndara sipas të ardhurave, gjinisë, moshës, racës, kombësisë, statusit migrues, paaftësisë, vendndodhjes gjeografike dhe karakteristikave të tjera përkatëse në kontekstin kombëtar të cdo vendi.

17.19 Deri në vitin 2030, të ngrihet mbi nismat ekzistuese për të zhvilluar masa të progresit për Zhvillimin e Qëndrueshëm që plotësojnë prodhimin e brendshëm bruto dhe mbështetjen ngritjen e kapaciteteve statistikore në vendet në zhvillim.

Komuna është përgjegjëse për ndërtimin e partneriteteve me akter të ndryshëm relevant për menaxhim të zhvillimit të qëndrueshëm dhe ofrim të shërbimeve dhe kushteve të denja për jetesë për qytetarët, si dhe ndërtimin e mekanizmave për mobilizim të burimeve financiare përmes rritjes të të hyrave vetanake dhe thithjes së investimeve të tjera.

Qëllimi I shtatëmbëdhjetë është integruar pjesërisht në kuadër të kornizës së PZHK-së, me fokus në mobilizimin e burimeve financiare për zbatim të strategjisë lokale, ndërtimin dhe fuqizimin e partneriteteve për zhvillim të qëndrueshëm të komunës.

Korniza e PZH-së integron dy nga gjashtë synimet relevante të qëllimit të shtatëmbëdhjetë.

Synimi 17.7 i QZHQ-ve adresohet nga dy qëllime të PZHK-së dhe dy synime përkatëse:


QËLLIMI 1: Zhvillim ekonomik i qëndrueshëm dhe rritje e punësimit në një qytet tërheqës dhe kreativ

Synimi 1.1 Vlerësimi i Universitetit publik dhe institucioneve të tjera të edukimit publik dhe privat, hulumtimeve, dhe lidhjet me sektorin ekonomik; të ulët distanca mes trajnimeve profesionale dhe tregut të punës;

QËLLIMI 7 Drejt një modeli të ri të zhvillimit hapësinor urban

Synimi 7.1 Bashkëpunim i përhershëm me komunat fqinje (Zona të mëdha urbane dhe Zona e kaltër të PHK) dhe agjencitë qendrore (Politikat duhet të reflektojnë realitetin aty ku njerëzit jetojnë dhe punojnë, ashtu siç bëjnë institucionet të cilat projektojnë apo dizajnojnë politika të tilla). Ndërlidhja e qyteteve dhe hapësirës rrethuese ndikojnë në rritjen e performancës kombëtare dhe të kualitetit të jetës. Prishtina duhet të jetë e lidhur ngushtë me Zonën e saj të gjerë urbane (TEK, Aeroporti, Stacioni hekurudhor F.) dhe të qyteteve me hapësirë të kaltër;

Edhe pse aktivizimi i burimeve të brendshme, përkatësisht synimi 17.1 nuk është adresuar në mënyrë specifike, PZHK përmes planit të aktiviteteve identifikon akterët dhe investorët përkatës për realizimin e qëllimeve të Komunës të parapara në kuadër të planit.



E synimeve relevante të Qëllimit 17 kanë pajtuesmeri të pjesëshme me synimet e PZHK-së

Hapat për integrimin e QZHQ-ve në PZHK të Prishtinës

Strategjitë lokale janë dokumente të cilat zbërthejnë vizionin për zhvillimin e Komunës për sfera të caktuara në qëllime, synime dhe aktivitete, bazuar në projeksionet e kapaciteteve hapësinore, njerëzore dhe financiare. Mandati i këtyre dokumenteve është rregullimi i menaxhimit të burimeve natyrore, orientimit të investimeve, programeve zhvillimore dhe ofrimit të shërbimeve të Komunës dhe akterëve të tjerë drejt vizionit të përbashkët për zhvillim të qëndrueshëm.

QZHQ-të ofrojnë orientime të qarta se cilat janë aspektet që duhet të mirren parasysh dhe çka duhet të synohet në mënyrë që të arrihet zhvillim i qëndrueshëm ekonomik, social dhe mjedisor.

Komuna ndërmerr 5 hapat vijues për përafrimin e PZHK-së me QZHQ-të:

- 1. Përcaktimi i prioritetëve strategjike, me proces gjithëpërfshirës.** Një nga sfidat globale në përmbushjen e QZHQ-ve është kushtueshmëria. Meqë kapacitetet financiare janë të limituara në raport me përmbushjen e QZHQ-ve, Komuna përcakton prioritetet e veta strategjike të cilat janë shtytës të zhvillimit të gjithëmbarshtëm dhe adresojnë sfidat kryesore të komunës duke u bazuar në pasqyrën e gjendjes ekzistuese. Është qenësore që akterët relevant të përfshihen në përcaktimin e prioritetëve të përbashkëta.
- 2. Pasqyra e gjendjes ekzistuese përmes treguesve të QZHQ-ve.** Komuna angazhohet në gjenerimin dhe mbledhjen e të dhënave të nevojshme për matjen e treguesve për synimet me prioritet, përkatësisht prioritetet strategjike të komunës. Varësisht nga treguesit, Komuna bashkëpunon dhe angazhohet në aktivitete të përbashkëta për gjenerim të të dhënave me institucione të tjera publike si p.sh. Policia e Kosovës rreth sigurisë urbane apo me OJQ të caktuara në raste të anketimeve si p.sh. Anketa rreth Viktimizimit apo Standardit Jetësor, etj.
- 3. Përafrimi i qëllimeve dhe synimeve të PZHK-së me QZHQ-të.** Komuna vlerëson se deri në çfarë mase mund të përafrojnë synimet e PZHK-së me ato të QZHQ-ve në bazë të kapaciteteve vetanake hapësinore, dhe mobilizimit të burimeve financiare në bashkëpunim me akterët e tjerë relevant. Ky proces në të shumtën e rasteve mbështetet me analiza shtesë, përtej treguesve të QZHQ-ve të cilët

P.sh. synimi 11.7 “Deri në vitin 2030, të sigurohet qasje e gjithëmbarshtëme në hapësirat publike të gjelbra, të sigurta, gjithëpërfshirëse dhe të arritshme, në veçanti për gratë dhe fëmijët, të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara”, i cili rekomandon se 50% e hapësirës së ndërtuar duhet të jetë hapësirë publike ka 2 tregues:

- 11.7.1: % e zonës së ndërtuar që është hapësirë e hapur për të gjithë, sipas gjinisë, moshës dhe personave me aftësi të kufizuara.
- 11.7.2: % e personave viktimë që kanë përjetuar ngacmim fizik ose seksual, sipas gjinisë, moshës, nivelit të aftësisë, vendit të ndodhjes, në 12 muajt e mëparshëm.

Mirëpo, për kontekstualizimin e synimit 11.7, përkatësisht përcaktimin e synimit për rritjen e fondit dhe përmirësimin e kualitetit të hapësirës publike në qytete të ndryshme të botës me mbështetjen e Programit Global të UN-Habitat-it për Hapësira Publike, janë analizuar shumë aspekte të hapësirës publike në nivel të qytetit, si p.sh.. tipologjia dhe shpërndarja e tyre, pronësia e tokës, dendësia banimore, kushtet ndërtimore në zonat më të cënuara, rrjeti i transportit publik dhe kualiteti i infrastrukturës përkatëse, infrastruktura rrugore duke përfshirë edhe rrjetin e shtigjeve për këmbësor dhe biciklistë, po gjithëashtu kualiteti i infrastrukturës teknike, llojet e aktiviteteve në këto hapësira, shfrytëzueshmëria, grupet e targetuara, etj.

shërbejnë si pikë fillestare (Shih tabelen për shembullin e synimit 11.7). Në mungesë të kapaciteteve vetanake, Komuna bashkëpunon me Universitetin apo angazhon kompani konsulente për fusha të specializuara në zhvillimin e analizave dhe ofrimin e rekomandimeve për orientim të politikave zhvillimore.

4. Përcaktimi i aktiviteteve për jetësimin e qëllimeve dhe synimeve përkatëse, në bashkëpunim me akterët e tjerë.

Komuna, në bashkëpunim me akterët relevant si institucionet e tjera publike, akademinë, komunitetin e biznesit, shoqërinë civile përcakton aktivitetet e nevojshme për përmbushjen e synimeve të përcaktuara, duke konsideruar kontributin potencial të të gjitha palëve në zbatimin e tyre.

5. Buxhetimi dhe ndarja e detyrave. Strategjitë duhet të buxhetohen, në bazë të projeksioneve financiare për periudha të caktuara. Në këtë fazë, Komuna definon natyrën e bashkëpunimit me akterët e ndryshëm, projektet dhe angazhimin përkatës. Poashtu, identifikon ngecjet në raport me gjenerimin e të hyrave vetanake dhe ndërmerr veprimet e nevojshme për përmirësimin e këtij sektori në administrimin lokal.

PRIORITETET KARSHI INVESTIMEVE KOMUNALE

Cilat janë prioritetet komunale?

Investimet kapitale 2014 – 2018

Buxheti i shpenzuar në Komunën e Prishtinës në investime kapitale¹ në 5 vitet e fundit ka arritur pikën kulminante në vitin

2017, ndërsa ka pësuar rënie prej **xx%** në vitin 2018. Trendi i investimeve sipas


sektorëve ka pësuar ndryshim evident ndër vite. Përderisa në vitin 2014 74% e

investimeve janë bërë në infrastrukturën rrugore dhe 10% në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit, në vitin 2018 ka një shpërndarje më të balancuar të investimeve me 35% të

investimeve në infrastrukturën rrugore dhe 38% në infrastrukturën e ujësjellësit dhe kanalizimit.

Ndërsa sektorët e tjerë, ka pasur

rënie të investimeve në infrastrukturën shkollore rreth 70% nga viti 2017 në vitin 2018, ndërsa nga viti 2016 investimet në trashëgiminë kulturore kanë pësuar rritje mbi 90%.




Burimet e të hyrave vjetore

Burimet e të hyrave vjetore për komunën e Prishtinës, sipas të dhënave për vitin 2014 – 2018, rreth 58% përbëhen nga granti qeveritar. Të hyrat vjetore kanë pësuar rritje prej rreth 10%, me një trend të vazhdueshëm dhe të balancuar të rritjes.

Burimet e të hyrave vetanake

Sa i përket të hyrave vetanake, nga viti 2014 deri në vitin 2017, të hyrat nga tarifat komunale dhe gjobat kanë pësuar rritje për mbi 30%, ndërsa të hyrat nga tatimi në pronë rreth 20%.

.



e buxhetit për vitin 2018 është gjeneruar nga të hyrat vetanake, rreth 58% nga granti qeveritar, ndërsa më pak se 1% nga donacionet.



e të hyrave vetanake për vitin 2018 është gjeneruar nga tarifat komunale, ndërsa rreth 24% nga tatimi në pronë dhe rreth 8% nga gjobat.

¹ Investimet kapitale qe përfshihen në këtë analizë janë investimet në infrastrukturën rrugore, Infrastruktura ujë dhe kanalizim, rrjeti i enegjisë elektrike; parqe, sheshe, kënde lojrash dhe fusha sportive; shkolla; kujdesi shëndetësor; trashëgimia kulturore; programe për integrimin gjinor dhe programe rinore;

Në raport me QZHQ-të grupi punues ka prioritzuar tri qëllimet vijuese dhe aktivitetet përkatëse:



- Strehim
- Relacioni në mes të zonës urbane dhe rurale
- Trashëgimia kulturore dhe natyrore
- Hapësirat publike



- Qasje në shërbime të përballueshme të energjisë
- Energji e rinovueshme
- Eficienca e energjisë



- Përdorimi i qëndrueshëm i ekosistemeve tokësore dhe ekosistemeve të ujërave të ëmbëla
- Menaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve
- Zvogëlimi i degradimit të habitateve natyrore

Prioritetet e përcaktuara nga grupi punues të cilat konsiderohet se adresojnë sfidat kryesore që Komuna i ka dhe përbjnë shtytësit e zhvillimit të qëndrueshëm është përmirësimi i politikave të strehimit dhe kualitetit urban të qytetit, energjisë së përballueshme dhe mbrojtjes së ekosistemeve. Këto prioritate ngërthejnë sektorët me më shumë investime komunale, por nuk trajtohen në plotni.

Veprimet për përmbushjen e QZHQ-ve dhe treguesit përkatës për raportim të progresit

Për ilustrim në tabelat e mëposhtme janë renditur disa nga aktivitetet që sektorët komunal mund të ndërmarrin, si dhe treguesit që mund të përdorin për raportimin e progresit në raport me përmbushjen e QZHQ-ve. Këto tabela ofrojnë një metodë për strukturimin e treguesve në strategjitë lokale dhe planeve të aktiviteteve në përgjithësi, të cilat mbindërtohen vartësisht nga konteksti komunal.

ARSIMI	TREGUESIT PËR MATJEN PROGRESIT NË RAPORT ME PËRMBUSHJEN E QZHQ-VE			
AKTIVITETET	Qëllimi 1: PA VARFËRI	Qëllimi 4: ARSIM CILËSOR	Qëllimi 8: PUNË DINJITOZE DHE RRITJE EKONOMIKE	Qëllimi 12: KONSUM DHE PRODHIM I PËRGJEGJSHËM
Identifikimi i sfidave të qasjes në arsim dhe sigurimi i qasjes në arsim, sidomos ndër komunitetet më të cënueshme;*	Treguesit e tjerë Numri i fëmijëve nga mosha 5 - 17 që jetojnë në varfëri të qasur në sistemin arsimor brenda vitit; (Ky tregues kontribuon në matjen e treguesit 1.4.1)	Treguesit e QZHQ-ve 4.2.2 Shkalla e pjesëmarrjes në të mësuarit e organizuar, për grupmoshat përkatëse në parashkollor, mësimin fillor, të mesëm të ulët, të mesëm të lartë, sipas gjinisë;	Treguesit e tjerë Numri i fëmijëve nga mosha 5 - 17 në punë të qasur në sistemin arsimor brenda vitit;	
Informimi, trajnimi, edukimi rreth Zhvillimit të Qëndrueshëm		Treguesit e tjerë Numri i personave të informuar për zhvillimin e qëndrueshëm; (Ky tregues kontribuon në matjen e treguesve të QZHQ-ve 4.7.1 dhe 12.8.1)		Treguesit e tjerë Numri i personave të informuar për zhvillimin e qëndrueshëm; (Ky tregues kontribuon në matjen e treguesve të QZHQ-ve 4.7.1 dhe 12.8.1)
Mbështetja e zingjirëve të shkurtër të furnizimit;**		Treguesit e QZHQ-ve 4.3.1 Shkalla e pjesëmarrjes të të rinjve dhe të rriturve në arsimin dhe formimin formal dhe jo-formal në 12 muajt e mëparshëm, sipas gjinisë;	Treguesit e QZHQ-ve 8.6.1 Përqindja e të rinjve (mosha 15-24 vjeçare) jo në arsim, punësim apo trajnim	
Perpilimi i Strategjive Lokale për Zhvillim Ekonomik;***			Treguesit e tjerë: Numri i programeve për zhvillim të kapaciteteve njerëzore – trajnimet teknike dhe profesionale, në koordinim me kërkesat e tregut;	

Në adresimin e kësaj qështje ky sektor bashkëpunon me:

* Sektorin e Mirëqenies Sociale

** Sektorin e Zhvillimit Ekonomik

*** Sektorin e Sherbimeve Publike, Zhvillimin Ekonomik, Kulurë, Rini dhe Sport, Mjedis, Qështjet Gjimore dhe Financa

SHËRBIME PUBLIKE, EMERGJENCA, PARQE DHE HAPËSIRA TË TJERA PUBLIKE

	TREGUESIT PËR MATJEN PROGRESIT NË RAPORT ME PËRMBUSHJEN E QZHQ-VE			
AKTIVITETET	Qëllimi 6: UJI I PASTËR DHE KANALIZIMEVE	Qëllimi 7: ENERGJI E PËRBALLUESHME DHE E PASTËR	Qëllimi 8: PUNË DINJITOZE DHE RRITJE EKONOMIKE	Qëllimi 9: INDUSTRI, INOVACION DHE INFRASTRUKTURË
Identifikimi i burimeve të nevojshme të ujit për furnizim me ujë të pijshëm;	Treguesit e QZHQ-ve: 6.3.2 Përqindja e trupave të ujit me cilësi të mirë të ujit të ambientit; Tregues të tjerë: Disponueshmëria e ujit m3 ujë për person në vit;			
Identifikimi i humbjeve të ujit dhe sanimi i sistemit të furnizimit;	Treguesit e QZHQ-ve: 6.4.1 Ndryshimi në efikasitetin e përdorimit të ujit me kalimin e kohës;			
Menaxhim i integruar i burimeve të ujit;*	Treguesit e QZHQ-ve: 6.5.1 Shkalla e zbatimit të menaxhimit të integruar të resurseve ujore (0-100); 6.5.2 % e zonave ndërkufitare të baseneve të ujit me plan operacional për bashkëpunimin në menaxhimin e tyre;			
Shfrytëzimi i burimeve të reja të ripërtëritshme të energjisë në institucionet publike;***		Treguesit e tjerë: % e energjisë së ripërtëritshme në totalin e konsumit të energjisë, në institucione publike; (Ky tregues kontribuon në matjen e treguesit 7.2.1)		

Investimi në përmirësimin e eficiencës së energjisë në institucionet publike, dhe të tjera,**		Treguesit e tjerë: % e objekteve publike që shfrytëzojnë teknologji të re të ndriqimit, ka izolim adekuat dhe promovon sjellje të ndërgjegjshme ndaj shpenzimeve të energjisë;		
Bashkëpunimi me sektorin jo-formal të ekonomisë për përmirësimin e kushteve të punës dhe inkurajimi i formalizimit,****			Treguesit e QZHQ-ve: 8.3.1 Përqindja e punësimit joformal në punësimin jo bujqësor, sipas gjinisë;	
Identifikimi i mangesive në qasje në TIK dhe internet dhe sigurimi i qasjes duke ofruar shërbime të tilla në hapësira publike si bibliotekat, etj.;				Treguesit e QZHQ-ve: 9.c.1 % e popullsisë e mbuluar nga një rrjet celular, sipas teknologjisë;
Mbështetja e zingjirëve të shkurtër të furnizimit *****			Treguesit e tjerë: Shkalla e shfrytëzimit të hapësirës së tregut komunal;	Treguesit e tjerë: % e tokave bujqësore aktive me qasje të lehtë në rrugë të përshtatshme për çdo stinë;

TREGUESIT PËR MATJEN E PROGRESIT NË RAPORT ME PËRMBUSHJEN E QZHQ-VE				
AKTIVITETET	Qëllimi 1: PA VARFËRI	Qëllimi 11: QYTETE DHE KOMUNITETE TË QËNDRUESHËM	Qëllimi 13: VEPRIM PËR KLIMËN	Qëllimi 16: PAQE DHE DREJTËSI, INSTITUCIONE TË FORTA
Rregullimi i brigjeve të lumenjëve, i projektuar në mënyrë adekuate që parandalon vërshimet, mbronë ekosistemin dhe	Treguesit e QZHQ-ve: 1.3.1 Numri i familjeve ne varferi te skajshmeqe jetojne ne zona te rrezuikuara nga fatkeqesite;	Treguesit e QZHQ-ve: 11.5.1 Numri i vdekjeve, personave të zhdukur dhe personave të prekur direkt nga fatkeqësitë për 100,000 banorë 11.5.2 Humbje e drejtpërdrejtë ekonomike në raport me PPV-në globale, dëmtimkritike i infrastrukturës dhe numri i ndërprerjeve të shërbimeve themelore, që i atribuohen fatkeqësive;	Treguesit e QZHQ-ve: 13.1.1 Numri i vdekjeve, personave të zhdukur dhe personave të prekur direkt nga fatkeqësitë për 100,000 banorë;	
Forcimi i aftësive ripërtëritëse dhe përshtatëse të komunitetit ndaj fatkeqësive natyrore dhe të tjera;**				
Menaxhimi i mbeturinave, riperdorimi dhe riciklimi si mjete për zvogëlimin e ndikimit në mjedis		Treguesit e QZHQ-ve: 11.6.1 Perqindja e mbeturinave të ngurta urbane të mbledhura rregullisht dhe me shkarkimit të duhur final nga mbetjet e ngurta urbane të krijuara, nga qytetet;		

Ndërgjegjesimi i publikut rreth rrezikut nga fatkeqësitë natyrore dhe masat për mbrojtje dhe rimëkëmbje;**	Treguesit e tjerë: Numri i personave që jetojnë në varfëri të informuar rreth temës;	Treguesit e tjerë: Numri i personave të informuar rreth temës;	Treguesit e tjerë: Numri i personave të informuar rreth temës;	
Ofrimi i hapësirave publike të sigurta dhe te gjelbra		Treguesit e QZHQ-ve: 11.7.1 % e zonës së ndërtuar të qyteteve që është hapësirë e hapur për përdorim publik për të gjithë, sipas gjinisë, moshës dhe personave me aftësi të kufizuara 11.7.2 % e personave viktimë të ngacmimit fizik ose seksual, sipas gjinisë, moshës, statusit të aftësisë së kufizuar dhe vendit të ndodhjes, në 12 muajt e mëparshëm;		Treguesit e QZHQ-ve: 16.1.4 % e personave që ndihen të sigurt duke ecur nëpër zonën ku jetojnë;

	TREGUESIT PËR MATJEN E PROGRESIT		
AKTIVITETET	Qëllimi 1: PA VARFËRI	Qëllimi 3: SHËNDET I MIRË DHE MIRËQENIE	Qëllimi 6: UJI I PASTËR DHE KANALIZIMEVE
Ofrimi i shërbimeve publike si qasja në ujë të pijshëm dhe rrjetin e kanalizimit, shtrirja dhe përmirësimin i infrastrukturës teknike;	Treguesit e tjerë: Numri i familjeve në varfëri të skajshme të kyqura ne sistemin e ujesjellesit dhe kanalizimit; Numri i familjeve në varfëri të kyqura në sistemin e ujesjellesit dhe kanalizimit;	Treguesit e tjerë: % e popullsisë e ekspozuar ndaj furnizimit jo të sigurt të shërbimeve të ujit dhe kanalizimit;	Treguesit e QZHQ-ve: 6.1.1 % e popullsisë që përdor shërbime të ujit të pijshëm të menaxhuara në mënyrë të sigurt;
Identifikimi i mangësive në qasje në energji të përballueshme për grupet më të cënueshme;	Treguesit e tjerë: Numri i familjeve ne varferi dhe varferi te skajshme pa qasje në energji të përballushme;		

Në adresimin e kësaj qështje ky sektor bashkëpunon me:

* Sektorin e Planifikimit Hapësinor

** Sektorin e Emergjencave

*** Sektorin e Administratës Publike

**** Sektorin e Zhvillimit Ekonomik

***** Sektorin e Arsimit dhe Zhvillimit Ekonomik

***** Sektorin e Sherbimeve Publike, Zhvillimin Ekonomik, Kulurë, Rini dhe Sport, Mjedis, Qështjet Gjinore dhe Financa

NË RAPORT ME PËRMBUSHJEN E QZHQ-VE

Qëllimi 7: ENERGJI E PËRBALLUESHME DHE E PASTËR	Qëllimi 8: PUNË DINJITOZE DHE RITJE EKONOMIKE	Qëllimi 11: QYTETE DHE KOMUNITETE TË QËNDRUESHËM
	Treguesit e tjerë: % e zonave aktive bujqësore me sistem të ujitjes; % e bizneseve dhe/apo zonave të biznesit në shërbime të ujit të pijëshëm dhe kanalizimit;	Treguesit e tjerë: % e njësive banimore në vendbanimet joformale të kyqura në sistemin e ujësjellësit dhe kanalizimit;
Treguesit e QZHQ-ve: 7.1.1 Përqindja e popullsisë me qasje në energji elektrike		

TREGUESIT PËR MATJEN E PROGRESIT NË RAPORT ME PËRMBUSHJEN E QZHQ-VE				
AKTIVITETET	Qëllimi 2: ZERO URI	Qëllimi 3: SHËNDET I MIRË DHE MIRËQENIE	Qëllimi 9: INDUSTRI, INOVACION DHE INFRASTRUKTURË	Qëllimi 15: JETA NË STERË
Masa për parandalimin e aksidenteve rrugore;**		Treguesit e QZHQ-ve: 3.6.1 % e vdekjeve për shkak të lëndimeve të trafikut rrugor; Treguesit e tjerë: % e rrugëve lokale të paisura me sinjalistikën adekuate, shtigje të sigurta për këmbësor dhe/ apo masa si polic të shtrirë;		
Zhvillimi dhe menaxhimi i infrastruktures rrugore dhe teknike përcjellëse;	Treguesit e tjerë: - Vëllimi produktit lokal bujqësor në transportin rrugor; - % e tokave bujqësore aktive me qasje të lehtë në rrugë të përshtatshme për çdo stinë;		Treguesit e QZHQ-ve: 9.1.1 % e popullsisë rurale që jetojnë brenda 2 km të rrugës të përshtatshme për çdo stinë; 9.4.1 Emetimet e CO2 për njësi të vlerës së shtuar; Treguesit e tjerë: Vëllimi i pasagjerëve dhe mallrave në transportin rrugor (Ky tregues kontribuon në matjen e treguesit 9.1.2)	
Koordinimi komunal për konservimin e korridoreve të gjelbra;*				Treguesit e tjerë: Numri i bashkëpunimeve gjatë vitit në adresimin e korridoreve të gjelbra;

ZHVILLIMI EKONOMIK

TREGUESIT PËR MATJEN E PROGRESIT NË RAPORT ME PËRMBUSHJEN E QZHQ-VE				
Aktiviteti	Qëllimi 1: PA VARFËRI	Qëllimi 2: ZERO URI	Qëllimi 8: PUNË DINJITOZE DHE RRITJE EKONOMIKE	Qëllimi 12: KONSUM DHE PRODHIM I PËRGJEGJSHËM
Transporti dhe magazinimi efektiv i produkteve ushqimore, si masë për zvogëlimin e mbetjeve ushqimore;		Treguesit e tjerë: Mbulushmeria (%) me shërbimin për magazinimin e produkteve ushqimore;	Treguesit e QZHQ-ve: Rendimenti bujqësor për vit;	Treguesit e QZHQ-ve: 12.3.1 Indeksi global i humbjes së ushqimit;
Mbështetja e prodhimit bujqësor dhe promovimi i zingjit të prodhimeve lokale ushqimore-lehtësime të taksave, subvencione, investime në tregje komunale, trajnime të bujqëve, etj;		Treguesit e QZHQ-ve: 2.3.1.Vëllimi i prodhimit për njësi të punës sipas klasave të madhësisë së ndërmarrjes bujqësore / baritore / pyjore; 2.4.1. Përqindja e zonës bujqësore e bujqësis produktive dhe të qëndrueshme;	Treguesit e tjerë: Shkalla e shfrytëzimit të hapësirës së tregut komunal; Kapacitetet njerëzore në menaxhimin dhe inspektimin ekushteve të mirëmbajtjes së produkteve ushqimore;	Treguesit e QZHQ-ve: 12.3.1 Indeksi global i humbjes së ushqimit;
Bashkëpunimi me sektorin jo-formal të ekonomisë për përmirësimin e kushteve të punës dhe inkurajimi i formalizimit;*			Treguesit e QZHQ-ve: 8.3.1 Përqindja e punësimit joformal në punësimin jo bujqësor, sipas gjinisë	
Perpilimi i Strategjive Lokale për Zhvillim Ekonomik;***	Treguesit e tjerë: Integrimi i masave për krijimin e vendeve të punës, zhvillimin e kapaciteteve njerëzore dhe rritjes së pagave;		Treguesit e tjerë: Vlerësimi i përfitimeve dhe kostove të turizmit së bashku me komunitetin; Vlerësimi i nevojave të tregut; Integrimi i masave për promovimin e NV dhe NM;	Treguesit e tjerë: Integrimi i masave për prodhim dhe konsum të qëndrueshem; (Ky tregues kontribuon në matjen e treguesit 12.1.1)

MJEDISI

	TREGUESIT PËR MATJEN PROGRESIT			
AKTIVITETET	Qëllimi 2: ZERO URI	Qëllimi 3: SHËNDET I MIRË DHE MIRËQENIE	Qëllimi 4: ARSIM CILËSOR	Qëllimi 6: UJI I PASTËR DHE KANALIZIMEVE
Menaxhimi i burimeve natyrore, tokës dhe burimeve të ujit, ne veçanti në zonat rurale; dhe zbatimi i masave për mbrojtjen e mjedisit;*	Treguesit e tjerë: Sipërfaqja e tokës bujqësore; Sasia e pesticideve dhe plehrave, dhe periudha e perdorimi;	Treguesit e tjerë: Sasia e pesticideve dhe plehrave, dhe periudha e perdorimit; Sipërfaqja e deponive joformale të mbeturinave;		Treguesit e tjerë: Përmbajtja e NB05, dhe ndotësve të tjerë në burimet ujore;
Informimi, trajnimi, edukimi rreth Zhvillimit të Qëndrueshëm, ndërgjegjësimi në raport me mbrojtjen e burimeve natyrore dhe habitateve, si të zvogëlojnë ndikimin në mjedis dhe ndryshime klimatike			Treguesit e tjerë: Numri i personave të informuar për zhvillimin e qëndrueshëm (Ky tregues kontribuon në matjen e treguesve të QZHQ-ve 4.7.1 dhe 12.8.1)	
Perpilimi i Strategjive Lokale për Zhvillim Ekonomik;**				

NË RAPORT ME PËRMBUSHJEN E QZHQ-VE			
Qëllimi 8: PUNË DINJITOZE DHE RRIJTJE EKONOMIKE	Qëllimi 12: KONSUM DHE PRODHIM I PËRGJEGJSHËM	Qëllimi 13: VEPRIM PËR KLIMËN	Qëllimi 15: JETA NË STERË
Treguesit e QZHQ-ve: 8.4.1 Material footprint, material footprint per capita;			Treguesit e QZHQ-ve: 15.1.1 Sipërfaqja pyjore si pjesë e sipërfaqes totale të tokës; 15.1.2 Përqindja e vendeve të rëndësishme për tokën dhe ujin e ëmbël; 15.2.1 Progresi drejt menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve; 15.3.1 Përqindja e tokës që është degraduar mbi sipërfaqen totale të tokës;
	Treguesit e tjerë: Numri i personave të informuar për zhvillimin e qëndrueshëm (Ky tregues kontribuon në matjen e treguesve të QZHQ-ve 4.7.1 dhe 12.8.1)	Treguesit e QZHQ-ve: 13.3.1 Numri i vendeve që kanë integruar zbutjen, përshtatjen, uljen e ndikimit dhe paralajmërimin e hershëm në programet mësimore primare, dytësore dhe terciare; - Kapacitete e fuqizuara në zbatimin e masave adaptive, te zbutjes së ndryshimeve klimatike;	Treguesit e tjerë: Numri i personave të informuar rreth masave për zvogëlimin e ndikimit në mjedis dhe ndryshime klimatike;
			Treguesit e tjerë: Masa për mbrojtjen e burimeve natyrore, tokës dhe burimeve të ujit;

FINANCA, PROKURIM, ADMINISTRATE PUBLIKE

TREGUESIT PËR MATJEN PROGRESIT NË RAPORT ME PËRMBUSHJEN E QZHQ-VE				
AKTIVITETET	Qëllimi 5: BARAZIA GJINORE	Qëllimi 7: ENERGJI E PËRBALLUESHME DHE E PASTËR	Qëllimi 8: PUNË DINJITOZE DHE RRITJE EKONOMIKE	Qëllimi 16: PAQE DHE DREJTËSI, INSTITUCIONE TË FORTA
Shfrytëzimi i burimeve të reja të ripërtëritshme të energjisë në institucionet publike;*		Treguesit e QZHQve: 7.2.1 Pjesa e energjisë së ripërtërishme në totalin e konsumit final të energjisë		
Investimi në përmirësimin e eficiencës së energjisë në institucionet publike, dhe të tjera;*		Treguesit e tjerë: Numri i objekteve publike që shfrytëzojnë teknologji të re të ndriqimit, ka izolim adekuat,		
Ofrimi i shërbimeve pa diskriminim gjinor;	Treguesit e QZHQve: 5.a.1 (a)Përqindja e popullsisë së përgjithshme bujqësore me pronësi ose të drejta të sigurta mbi tokën bujqësore, sipas gjinisë; dhe (b) pjesa e ndare e grave midis pronarëve ose bartësve të të drejtave të tokës bujqësore, sipas llojit të qëndrimit			
Mbështetja e praktikave të drejta të punësimit	Treguesit e QZHQve: 5.5.1Përqindja e vendeve të mbajtura nga gratë në (a) parlamentet kombëtare dhe (b) qeveritë lokale			

Caktimi i grave në pozita vendim-marrëse ;	Treguesit e QZHQve: 5.5.1Përqindja e vendeve të mbajtura nga gratë në (a) parlamentet kombëtare dhe (b) qeveritë lokale;			
Ofrimin e mjedisit të sigurtë të punës, pagesë të njëjtë për punë të njëjtë;			Treguesit e tjerë: Niveli i kenaqshmerise me kushtet e punes ne administraten lokale; Dallimi (Euro) ne pagesë në mes te gjinive për punen e njëjtë;	
Adresimi i korrupsionit, identifikimi, parandalimi dhe raportimi				Treguesit e QZHQve 16.5.1 Përqindja e personave të cilët kanë pasur të paktën një kontakt me një zyrtar publik dhe që kanë paguar ryshfet një zyrtarë publik ose I është kërkuar ryshfet nga këta zyrtarë publikë gjatë 12 muajve të kaluar 15.5.2. % e bizneseve që kanë pasur të paktën një kontakt me shërbyes civil dhe ka paguar apo i është kërkuar pagesë joligjore gjatë 12 muajve të fundit; Treguesit e tjerë: Numri i rasteve të ndëshkuara të rasteve të vërtetuara të korrupsionit;
Ofrimi i qasjes në dokumente publike				Treguesit e tjerë: % e kërkesave për qasje në dokumente publike të shqyrtuara sipas ligjit;

	TREGUESIT PËR MATJEN PROGRESIT				
AKTIVITETET	Qëllimi 1: PA VARFËRI	Qëllimi 2: ZERO URI	Qëllimi 3: SHËNDET I MIRË DHE MIRËQENIE	Qëllimi 4: ARSIM CILËSOR	Qëllimi 5: BARAZIA GJINORE
Praktika të prokurimit,**					
Alokimi i buxhetit për përmbushjen e QZHQve;	Treguesit e QZHQ-ve: 1.b.1 Përqindja e shpenzimeve periodike qeveritare dhe kapitale për sektorët që në mënyrë joproportionale përfitojnë gratë, grupet e varfëra dhe të cënueshme	Treguesit e QZHQ-ve: 2.a.2 Burimet totale zyrtare (ndihma zyrtare për zhvillim dhe burime të tjera zyrtare) në sektorin e bujqësisë	Treguesit e QZHQ-ve: 3.b.2 Totali i ndihmës zyrtare neto të zhvillimit për hulumtimet mjekësore dhe sektorët e shëndetësisë primare	Treguesit e QZHQ-ve: 4.b.1 Vëllimi i burimeve të ndihmës zyrtare për zhvillim të bursave sipas sektorëve dhe llojit të studimit	Treguesit e QZHQ-ve: 5.a.1 (a)Përqindja e popullsisë së përgjithshme bujqësore me pronësi ose të drejta të sigurta mbi tokën bujqësore, sipas gjinisë; dhe (b) pjesa e ndare e grave midis pronarëve ose bartësve të të drejtave të tokës bujqësore, sipas llojit të qëndrimit

NË RAPORT ME PËRMBUSHJEN E QZHQ-VE				
Qëllimi 7: ENERGJI E PËRBALLUESHME DHE E PASTËR	Qëllimi 8: PUNË DINJITOZE DHE RRIJTE EKONOMIKE	Qëllimi 10: ELIMINIMI I PA- BARAZIVE PËRBRENDIA DHE NDËRMJET SHTETEVE	Qëllimi 11: QYTETE DHE KOMUNITETE TË QËNDRUESHËM	Qëllimi 12: KONSUM DHE PRODHIM I PËRGJEGJSHËM
Treguesit e tjerë: Kritere të qëndrueshmërisë, duke kontribuar në zvogëlimin e shpenzimeve publike në energji;	Treguesit e tjerë: Kriteret për sigurinë në punë dhe kushteve të barabarta të punës;	Treguesit e tjerë: Kritere që pamundësojnë diskriminimin		Treguesit e tjerë: Kritere të emetimit të karbonit dhe mbeturinave nga ofruesit potencial të shërbimeve;
Treguesit e QZHQ-ve: 7.a.1 Burimet financiare ndërkombëtare për vendet në zhvillim në mbështetje të kërkimit dhe zhvillimit të energjisë së pastër dhe prodhimit të energjisë së rinovueshme, duke përfshirë sistemet hibride 7.b.1 Investimet në efikasitetin e energjisë si pjesë e PBB-së dhe sasia e investimeve të huaja direkte në transferet financiare për infrastrukturën dhe teknologjinë për shërbime të zhvillimit të qëndrueshëm	Treguesit e QZHQ- ve: 8.b.1 Shpenzimet totale qeveritare në programet e mbrojtjes sociale dhe punësimit si pjesë e buxheteve kombëtare dhe PBB-së		Treguesit e QZHQ-ve: 11.c.1 Përqindja e mbështetjes financiare për vendet më pak të zhvilluara që është alokuar për ndërtimin dhe rinovimin e ndërtesave të qëndrueshme, elastike dhe efikas të burimeve duke shfrytëzuar materialet lokale; 11.4.1 Shpenzimet totale për kokë banori (publike dhe private) në prezervimin, mbrojtjen dhe konzervimin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore, tipas tipit të trashëgimisë (kulturore, natyrore, e përzier, destinacion i Trashëgimisë Botërore), nivelit të qeverisjes (qëndrore, regjionale, lokale), lloji i shpenzimit (shpenzim operues/ investim) dhe tipi i investimit privat (dhurimet in-kind, sektori jo- fitimprurës privat dhe sponzorimi);	

MIRËQENIE SOCIALE DHE QËSHTJE GJINORE

TREGUESIT PËR MATJEN E PROGRESIT NË RAPORT ME PËRMBUSHJEN E QZHQ-VE		
AKTIVITETET	Qëllimi 1: PA VARFËRI	Qëllimi 2: ZERO URI
Zbatimi i skemave të ndihmës sociale;	Treguesit e QZHQ-ve: 1.3.1 % e popullsisë e mbuluar nga sistemet e mbrojtjes sociale, sipas gjinisë, duke dalluar fëmijët, personat e papunë, personat e moshuar, personat me aftësi të kufizuara, gratë shtatzëna, të porsalindurit, viktimat e plagosjes në punë , të varfërit dhe të cënueshëmit Treguesit tjerë: % e familjeve (personave) që jetojnë në varfëri te skajshme apo varfëri që gëzojnë asistencë sociale;	
Identifikimi i personave që jetojnë në varfëri dhe varfëri te skajshme;	Treguesit e QZHQ-ve 1.1.1 Përqindja e popullsisë nën vijën ndërkombëtare të varfërisë, sipas gjinisë, moshës, statusit të punësimit dhe vendndodhjes gjeografike (urbane / rurale) 1.2.1 Përqindja e popullsisë që jeton nën kufirin kombëtar të varfërisë, sipas gjinisë dhe moshës	
Identifikimi i rasteve të mos-ushqyerjes tek fëmijët, përmes institucioneve shkollore dhe shëndetësore;		Treguesit e QZHQ-ve: 2.1.1 Denduria e ushqyerjes së pamjaftueshme Treguesit e tjerë: Numri i rasteve të identifikuara të mos apo ushqyerjes së pamjaftueshme te fëmijët

TREGUESIT PËR MATJEN PROGRESIT NË RAPORT ME PËRMBUSHJEN E QZHQ-VE				
AKTIVITETET	Qëllimi 4: ARSIM CILËSOR	Qëllimi 8: PUNË DINJITOZE DHE RRITJE EKONOMIKE	Qëllimi 11: QYTETE DHE KOMUNITETE TË QËNDRUESHËM	Qëllimi 16: PAQE DHE DREJTËSI, INSTITUCIONE TË FORTA
Sigurimi i qasjes në arsim, sidomos ndër komunitetet më të cënueshme;*	Treguesit e QZHQve: 4.1.1 Përqindja e fëmijëve dhe të rinjve (a) në klasat 2/3; (b) në fund të fillores; (c) në fund të arsimit të mesëm të ulët, të paktën një nivel minimal të aftësisë në (i) leximin dhe (ii) matematikën, sipas gjinisë 4.2.2 Shkalla e pjesëmarrjes në mësim të organizuar (5-18), sipas gjinisë Treguesi e tjerë: Numri i fëmijëve në punë të qasur në sistemin arsimor.	Treguesit e tjerë: Numri i të rriturve në mësim profesional		
Identifikimi i sfidave të qasjes në arsim, sidomos ndër komunitetet më të cënueshme;*	Treguesit e tjerë: Numri i fëmijëve nga moshë 5 deri 18 që nuk kanë qasje në arsim			
Identifikimi i fëmijëve në rrezik/në punë;		8.7.1 % dhe numri i fëmijëve të moshës 5-17 vjeç të cilët angazhohen në punën e fëmijëve, sipas gjinisë dhe moshës		

Reduktimi i dhunës dhe ngacmimeve në zona urbane			11.7.2 % e personave viktimë e ngacmimeve fizike ose seksuale, me gjini, moshë, niveli i aftësisë dhe vendndodhje, në 12 mujat e kaluar Treguesit e tjerë: Mbulueshmëria e hapësirave publike (rrugëve, parqeve, shesheve, ...) me ndriqim publik; Mbulueshmëria e hapësirave publike me CCTV apo forma të tjera të vëzhgimit;	16.1.4 % e popullatës që ndjehen të sigurtë duke ecur vetëm përreth hapësirave ku jetojnë
---	--	--	---	--

Në adresimin e kësaj qështje ky sektor bashkëpunon me:

*Arsim, Mireqenie

**Mireqeni, Qeshtje Gjimore

PLANIFIKIM, INSPEKTIM, PRONË

TREGUESIT PËR MATJEN PROGRESIT NË RAPORT ME PËRMBUSHJEN E QZHQ-VE				
Aktiviteti	Qëllimi 1: PA VARFËRI	Qëllimi 2: ZERO URI	Qëllimi 3: SHËNDET I MIRË DHE MIRËQENIE	Qëllimi 5: BARAZI GJINOR
Menaxhimi i burimeve natyrore, tokës dhe burimeve të ujit, ne veçanti në zonat rurale; dhe zbatimi i masave për mbrojtjen e mjedisit;*		Treguesit e tjerë: 1. Siperfaqja e tokës bujqësore; 2. Sasia e pesticideve dhe plehrave, dhe periudha e përdorimit	Treguesit e tjerë: 1. Sasia e pesticideve dhe plehrave, dhe periudha e përdorimit. 2. Siperfaqja e deponive joformale të mbeturinave;	
Promovimi i transportit publik;**			Treguesit e tjerë: Numri i pasagjereve në baza vjetore; Efikasiteti i linjave në aspektin kohor; Kualiteti i autobuseve;	
Identifikimi dhe adresimi i pengesave në menaxhimin e tokës dhe pronësi;***				5.a.1 (a) Përqindja e popullsisë së përgjithshme bujqësore me pronësi ose të drejta të sigurta mbi tokën bujqësore, sipas gjinisë; dhe (b) pjesa e ndare e grave midis pronarëve ose bartësve të të drejtave të tokës bujqësore, sipas llojit të qëndrimit

Rregullimi i tokës dhe tregut të banimit, duke siguruar të drejtën në strehim për banorët më të varfër;****	Treguesit e tjerë: Numri i familjeve ne varferi dhe varferi te skajshme te akomoduara nga administrata lokale		
---	--	--	--

Aktiviteti	Qëllimi 5: BARAZI GJINOR	Qëllimi 7: ENERGJI E PËRBALLUESHME DHE E PASTËR	Qëllimi 11: QYTETE DHE KOMUNITETE TË QËNDRUESHËM	Qëllimi 15: JETA NË STERË
Menaxhimi i burimeve natyrore, tokës dhe burimeve të ujit, ne veçanti në zonat rurale; dhe zbatimi i masave për mbrojtjen e mjedisit;*				
Parandalimi i zgjerimit të vendbanimeve joformale;			Treguesit e SDG-ve: 11.1.1Përqindja e popullsisë urbane që jeton në lagjet e varfra, vendbanimet joformale ose strehimi joadekuat Treguesit e tjerë: Sipërfaqja e vendbanimeve joformale;	

Promovimi i transportit publik;**		Treguesit e tjerë: % e konsumit të energjisë dhe lirimi i karbonit	Treguesit e SDG-ve: 11.2.1 Përqindja e popullsisë që ka qasje të përshtatshme në transportin publik, sipas gjinisë, moshës dhe personave me aftësi të kufizuara	
Mbrojtja e trashëgimisë kulturore të prekshme dhe të paprekshme***			Treguesit e SDG-ve: 11.4.1 Shpenzimet totale (publike dhe private) për person të shpenzuara për mbrojtjen dhe ruajtjen e të gjithë trashëgimisë kulturore dhe natyrore sipas llojit të trashëgimisë (përcaktimi kulturor, natyror, i përzier dhe i Trashëgimisë Botërore), niveli i qeverisë (kombëtare, rajonale dhe lokale / komunale), lloji i shpenzimeve (shpenzimet operative / investimet) dhe lloji i financimit privat (donacionet në natyrë, sektori privat jofitimprurës dhe sponsorizimi) Treguesit e tjerë: Numri i objekteve në listën e objekteve me vlerë të trashëgimisë të integruara në listën e trashëgimisë në mbrojtje	

Menaxhim i integruar i burimeve të ujit;**	Treguesit e SDG-ve: 6.5.1 Shkalla e zbatimit të menaxhimit të integruar të resurseve ujore (0-100) (një proces që promovon zhvillimin dhe menaxhimin e koordinuar të ujit, tokës dhe burimeve të lidhura me të, në mënyrë që të rrisin mirëqenien ekonomike dhe sociale në mënyrë të barabartë, pa kompromentuar qëndrueshmërinë e ekosistemeve vitale) 6.5.2 % e hapësirave të pellgjeve ujore ndërkufitare me marrëveshje operationale për bashkëpunim për ujin			
Koordinimi komunal për konservimin e korridoreve të gjelbra;**				Treguesit e tjerë: Numri i projekteve të përbashkëta në adresimin e konservimit të korridoreve të gjelbra.
Rregullimi i tokës dhe tregut të banimit, duke siguruar të drejtën në strehim për banorët më të varfër;****			Treguesit e SDG-ve: 11.1.1 Përqindja e popullsisë urbane që jeton në lagjet e varfra, vendbanimet joformale ose strehimi joadekuat Treguesit e tjerë: Numri i familjeve në varferi dhe varferi të skajshme të akomoduar nga administrata lokale	

Definimi dhe identifikimi i trashëgimisë kulturore të prekshme dhe të paprekshme;***		Treguesit e tjerë: Numri i monumenteve të trashëgimisë kulturore të përfshira në listën e monumenteve të mbrojtura të trashëgimisë kulturore	
--	--	---	--

Në adresimin e kësaj çështje ky sektor bashkëpunon me:

*Mjedis

**Shërbime publike

***Kulture, rinia, sport

****Prone

TREGUESIT PËR MATJEN PROGRESIT NË RAPORT ME PËRMBUSHJEN E QZHQ-VE					
Aktiviteti	Qëllimi 1: PA VARFËRI	Qëllimi 4: ARSIM CILËSOR	Qëllimi 8: PUNË DINJITOZE DHE RITJE EKONOMIKE	Qëllimi 9: INDUSTRI, INOVACION DHE INFRASTRUKTURË	Qëllimi 11: QYTETE DHE KOMUNITETE TË QËNDRUESHËM
Perpilimi i Strategjive Lokale për Zhvillim Ekonomik;***					
Mbrojtja e trashëgimisë kulturore të prekshme dhe të papakshme**					Treguesit e SDG-ve 11.4.1 Shpenzimet totale (publike dhe private) për person të shpenzuara per mbrojtjen dhe ruajtjen e të gjithë trashëgimisë kulturore dhe natyrore sipas llojit të trashëgimisë (përcaktimi kulturor, natyror, i përzier dhe i Trashëgimisë Botërore), niveli i qeverisë (kombëtare, rajonale dhe lokale / komunale), lloji i shpenzimeve (shpenzimet operative / investimet) dhe lloji i financimit privat (donacionet në natyrë, sektori privat jofitimprurës dhe sponsorizimi) Treguesit e tjerë: Numri i objekteve ne listen e objekteve me vlere te trashegimise te integruara ne listen

					e trashëgimise nën mbrojtje
Definimi dhe identifikimi i trashëgimisë kulturore të prekshme dhe të paprekshme;*					Treguesit e tjerë: Numri i monumenteve të trashëgimisë kulturore të përfshira në listën e monumenteve të mbrojtura të trashëgimisë kulturore

Në adresimin e kësaj qështje ky sektor bashkëpunon me:

*Planifikim, Urbanizem

** Planifikim, Urbanizem, Inspeks

***Arsim, Zhvillim Ekonomik, Mjedis, Qeshtje Gjinore

KAPACITETET KOMUNALE PËR MENAXHIMIN E LOKALIZIMIT TË QZHQ-VE

Cilat janë nevojat për fuqizimin e kapaciteteve komunale për lokalizimin e QZHQ-ve

KAPACITETET KOMUNALE – TË GJETURAT NGA PYETESORI

SA KA KOMUNA NJOHURI RRETH QZHQ-VE?

- Informimi
Komuna e Prishtinës nuk është e informuar rreth QZHQ-ve.
- Integrimi i QZHQ-ve në strategji komunale
Deri më tani nuk ka patur sesione informuese rreth agjendes 2030, iniciativë për përafrimin e strategjive lokale me kornizën e QZHQ-ve apo krijimin e mekanizmave institucional për integrimin dhe monitorimin e progresit në përmbushjen e këtyre qëllimeve.

SA KA KOMUNA PËRVOJË DHE KAPACITETE NJERËZORE PËR HARTIMIN E STRATEGJIVE LOKALE?

- Modaliteti i hartimit të strategjive
Strategjitë lokale, të integruara dhe sektorale, në Komunën e Prishtinës janë hartuar me nën-kontraktim të kompanive të specializuara dhe me angazhim aktiv të stafit komunal në faza të ndryshme të procesit.
- Roli i stafit komunal në procesin e hartimit të strategjive
Stafi komunal përcaktohet përmes vendimeve nga Kryetari, i cili në koordinim me Drejtorët e Drejtorive përkatëse përcakton anëtarët e Grupit Punues. Grupi punues ka shërbyer si lehtësues i procesit në raport me kompaninë e nënkontraktuar, sektorët relevant komunal, institucionet tjera publike dhe komunitetin e gjërë, si në fazën e mbledhjes së të dhënave, zhvillimit të kornizës zhvillimore, përcaktimit të qëllimeve deri në planin e veprimit për zbatimin e strategjisë. Në procesin e hartimit të PZHK-së Grupi punues ka kontribuar në aspektin përmbajtësor, si në mbledhjen e të dhënave, hartimin e Vizionit, përcaktimin e skenarit zhvillimor, si dhe definimin e qëllimeve, synimeve dhe aktiviteteve.
- Kapaciteti i stafit komunal në zhvillimin e politikave – plane / strategji / programe zhvillimore të integruara dhe sektoriale
Gjithësesi Komuna e Prishtinës ka kapacitete të pakta sa l përket aspektit kuantitativ, por edhe me pregaditjen e nevojshme profesionale për hartimin e politikave lokale me forca vetanake, që orienton zhvillim të integruar dhe të qëndrueshëm ekonomik, social dhe mjedisor.

SA KA KOMUNA PËRVOJË DHE MJETE PËR MENAXHIMIN E PROCESVE TË HARTIMIT TË STRATEGJIVE LOKALE?

- Mjetet për menaxhimin e proceseve gjithëpërfshirëse
Pjesëmarrja gjithëpërfshirëse e publikut në proceset e hartimit të strategjive vazhdon të jetë sfidë për komunën, sidomos kur bëhet fjalë për grupet më të cënueshme si gratë dhe vajzat, fëmijët, personat me nevoja të veçanta apo grupet etnike. Gjithësesi, komuna nuk posedon mjete metodologjike që sigurojnë pjesëmarrje gjithëpërfshirëse në procese të hartimit të strategjive.
- Kapaciteti i stafit komunal në organizimin, koordinimin dhe lehtësimin e proceseve gjithëpërfshirëse me ndjeshmëri gjinore

Edhe pse komuna është angazhuar në mënyrë aktive në lehtësimin e proceseve të hartimit të strategjive lokale, nuk posedon pregaditjen e nevojshme profesionale dhe numrin e mjaftueshëm të stafit për zbatim dhe menaxhim të proceseve gjithëpërfshirëse me ndjeshmëri të theksuar ndaj grupeve më të ndjeshme të komunitetit.

SA KA KOMUNA MJETE DHE KAPACITETE NJERËZORE PËR MONITORIMIN DHE VLERËSIMIN E STRATEGJIVE LOKALE?

- **Përvoja në monitorimin e zbatimit të strategjive**
Stafi komunal ka përvojë në vlerësimin e zbatimit të strategjive, më specifikisht Planit Zhvillimor Komunal.
- **Raportet e progresit**
Raportimi rreth progresit të zbatimit të kësaj strategjie bëhet përmes raporteve tremujore dhe vjetore. Gjithësesi kjo praktikë nuk gjenë zbatim sa i përket dikastereve të tjera komunale përfshirë edhe Planin Zhvillimor Komunal. Edhe pse me nenin 10 pika 3 të Ligjit nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinor Kuvendi Komunal obligohet të shqyrtoj Raportin Monitorues të Zbatimit për dokumentet e planifikimit hapësinor, deri më tani Komunat nuk kanë në dispozicion udhëzime për monitorim të progresit të zbatimit apo modele të konsoliduara të raportimit rreth zbatimit të strategjive hapësinore apo atyre sektorial.

SI QËNDRON KOMUNA ME TË DHËNA KOMUNALE DHE SA KA KAPACITETE NJERËZORE PËR MENAXHIM TË BAZËS SË TË DHËNAVE KOMUNALE?

Modaliteti i menaxhimit të të dhënave

Komuna e Prishtinës është angazhuar në menaxhimin e të dhënave komunale, si në formatin digjital ashtu edhe atë analog (fizik). Menaxhimi i të dhënave komunale është bërë nga stafi komunal, në mënyrë sistematike për të dhënat si: ... apo me qasje të veçantë në funksion të hartimit të strategjive të caktuara, si p.sh. Plani Zhvillimor Komunal .

- **Aktivitetet**
Këtu përfshihet krijimi i të dhënave, grumbullimi i të dhënave nga institucione të tjera publike lokale dhe qendrore, përpunimin e të dhënave si dhe përditësimin e tyre, në fusha të ndryshme tematike si planifikimi hapësinor, mjedisi, zhvillimi ekonomik, kulturë dhe sport.
- **Lloji i të dhënave**
Sa i përket llojit të të dhënave Komuna ka ngecje në të dhënat numerike, tekstuale dhe hapësinore rreth edukimit, shëndetësisë dhe mirëqenie sociale. Ndërsa posedon të dhëna hapësinore, numerike dhe tekstuale sa i përket fushave të tjera. Komuna konsideron se fondi i të dhënave ekzistuese është i mjaftueshëm për raportim të treguesve të QZHQ-ve, ndërsa sfida më e madhe konsiderohen të dhëna të zbërthyera në baza gjinore, moshore dhe nivelit të aftësisë.
- **Posedimi i bazës së konsoliduar të të dhënave**
Të dhënat komunale kryesisht menaxhohen nga drejtoritë përkatëse dhe kabineti i kryetarit. Gjithësesi këto të dhëna nuk janë të konsoliduara në formë të integruar.
- **Posedimi i protokolleve për menaxhimin e të dhënave**

Komuna posedon protokolle për menaxhimin e të dhënave në kuadër të drejtorive përkatëse, të cilat janë në përputhje me legjislacionin përkatës për qasje në dokumente publike dhe atë për mbrojtjen e të dhënave personale.

- Bashkëpunimi me institucionet e tjera për bashkë-prodhimin e të dhënave

Nuk është regjistruar ndonjë iniciativë për bashkëpunim me institucione të tjera publike për bashkë-prodhimin e të dhënave për fusha të caktuara p.sh. pasqyrë rreth sigurisë publike në territorin e Komunës në bashkëpunim me Policinë e Kosovës.

- Kapacitetet njerëzore në krijimin, grumbullimin, përpunimin dhe përditësimin e të dhënave

Edhe pse procesi i PZHK-së ka dëshmuar se Komuna ka kapacitetin teknik për menaxhimin e procesit të mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave hapësinore, numerike dhe tekstuale, ka ngecje sa i përket njohurive rreth zhvillimit dhe menaxhimit të databazës së integruar hapësinore komunale.

CILI ËSHTË KOORDINIMI DHE BASHKËPUNIMI NDËR INSTITUCIONAL DHE ME SHOQËRINË CIVILE?

Komuna numëron një sërë aktivitete të përbashkëta me institucione të tjera publike, komuna fqinje, nivelin qendror dhe organizata joqeveritare.

- Vlerësimi i bashkëpunimit me nivelin qendror

Komuna e Prishtinës vlerëson bashkëpunimin me nivelin qendror si të mire, kryesisht sa i përket ofrimit të mbështetjes në interpretime ligjore dhe mbështetjes së procesit të hartimit të Planit të ri Zhvillimor Komunal.

Fuqizimi I kapaciteteve komunale drejt Zhvillimit të Qëndrueshëm

Agjenda 2030 ofron një kornizë gjithëpërfshirëse, e cila përbën një platformë shumë të përshtatshme për të lehtësuar përafrimin e politikave dhe aktiviteteve konkrete në mes të akterëve të ndryshëm në nivelin lokal apo regjional si nga institucionet publike, academia, komuniteti i biznesit, organizata joqeveritare që përfaqësojnë grupe të ndryshme të komunitetit dhe vetë komunitetin, drejt disa qëllimeve të përbashkëta për planetin dhe njerëzimin në nivelin global drejt zhvillimit të integruar dhe të qëndrueshëm social, ekonomik dhe mjedisor.

RREGULLORJA KOMUNALE PËR QZHQ-TË. Komuna përpilon rregullore komunale përmes të cilës konfirmon zotimin politik dhe ofron bazën e nevojshme ligjore për integrimin e QZHQ-ve në praktikën ditore sa i përket ofrimit të shërbimeve komunale, politikave zhvillimore lokale, buxhetit vjetor si dhe projekteve dhe programeve zhvillimore në fusha të ndryshme. Kjo rregullore ndër të tjera definon skemën organizative institucionale apo *platformen institucionale për integrimin dhe raportimin rreth QZHQ-ve*, detyrat dhe përgjegjësitë respektive. Poashtu, rregullon bashkëpunimin me institucionet dhe akterë të tjerë relevant në funksion të përmbushjes së QZHQ-ve të caktuara, si dhe modalitetet e raportimit tek niveli qëndror.

PLATFORMA INSTITUCIONALE PËR INTEGRIMIN DHE RAPORTIMIN RRETH QZHQ-VE. Komuna themelon entitetet e nevojshme për vlerësimin e pajtueshmërisë së strategjive lokale dhe mekanizmave të tjerë institucional me QZHQ-të, kontekstualizimit të kësaj kornize, zbatimin, monitorimin dhe raportimin rreth përmbushjes së QZHQ-ve. Poashtu, krijon mekanizmat e nevojshëm për lehtësimin e dialogut dhe bashkëpunimit për veprim të koordinuar me akterët e tjerë si në nivel lokal apo regjional në gjenerimin e të dhënave, hartimin e politikave, realizimin e projekteve projekteve dhe raportimit rreth përmbushjes së QZHQ-ve.

Idetë fillestare për entitete të mundshme të kësaj platforme janë:

Grupi punues QZHQ-ve, i cili bënë vlerësimin e pajtueshmërisë së politikave lokale dhe mekanizmave të tjerë institucional me QZHQ-të dhe ofron rekomandimet për përmirësim;

Bordi i shefave të sektorëve, i cili koordinon punën në mes të sektorëve të drejtorive të ndryshme komunale dhe përpilon planin e veprimit në raport me akterët e jashtëm, si dhe raporton në bordin e drejtorëve për progresin në raport me përmbushjen e QZHQ-ve;

Forumi komunal, i cili përmes nën-forumeve tematike (si p.sh. Këshilli Komunal i Sigurisë në Bashkësi i cili do të adresonte 3 nga QZHQ-të në adresimin e sigurimit në trafik (QZHQ 3), ngacmimeve seksuale (QZHQ 11) dhe dhunën (QZHQ 16)) koordinon politikat dhe veprimin e akterëve të ndryshëm që veprojnë në territorin e Komunës.

Forumi ndër-komunal, i cili shërben për përcaktimin e projekteve dhe programeve të përbashkëta zhvillimore, mbështetjes profesionale në fusha të caktuara, ndarjes së përvojave dhe mësimave të mësuara.

UDHËZUES PËR INTEGRIMIN E QZHQ-VE, VLERËSIMIN, MONITORIMIN DHE RAPORTIMIN E ZBATIMIT TË STRATEGJIVE LOKALE PËRMES PROCESEVE GJITHËPËRFSHIRËSE. Komuna me mbështetjen e partnerëve dhe nivelin qëndror harton udhëzues të përshtatshëm që mbështesin stafin komunal hap-pas-hapi në zbatimin e detyrave të nevojshme për integrimin dhe raportimin rreth përmbushjes së QZHQ-ve. Disa nga mjetet të cilat janë identifikuar si të nevojshme janë:

Mjete për vlerësim të pajtueshmërisë së strategjive me QZHQ-të. Ky plan ofron një metodologji të vlerësimit të pajtueshmërisë së verzionit të hershëm të Planit Zhvillimor Komunal dhe QZHQ-ve, e cila është trajtuar në kapitullin **PAJTUESHMËRIA E ZHVILLIMOR KOMUNAL SË PRISHTINËS ME QZHQ-TË.** Kjo metodologji është e aplikueshme edhe për strategjitë e tjera lokale. Për ilustrim është bashkangjitur edhe Shtojca me udhëzimet përkatëse. Gjithësesi hapa të më tutjeshëm duhet të ndërmerren për plotësimin/ përafrimin e PZHK-së me QZHQ-të (për më tepër detaje shih “Rekomandimet për përafrimin e PZHK-së me QZHQ-të”).

Mjete për monitorimin dhe raportimin e zbatimit të strategjive dhe QZHQ-ve. Këto mjete kanë për qëllim të sigurojnë harmoni në mes të strategjive, buxhetit vjetor dhe realizimit të projekteve dhe bashkëpunimeve të komunës me akter të tjerë. Në mënyrë që monitorimi i zbatimit të jetë i mirëfillt, është qenësore që strategjitë të posedojnë strukturë të mirëfillt të zbërthimit të strategjisë në qëllime të qarta, synime të matshme dhe të shtriera në kohë, veprime adekuate dhe tregues përkatës. Një strukturë e tillë mundëson monitorim dhe raportim të mirëfillt rreth përmbushjes së QZHQ-ve poashtu.

Mjete për vlerësim të zbatimit të strategjive. Vlerësimi i zbatimit të strategjive si i tillë është i domosdoshëm në rastet kur nuk ka monitorim dhe raportim sistematik rreth zbatimit të strategjisë. Edhe pse kjo ndryshon nga natyra e strategjive që adresohen, mjete të tilla duhet të ofrojnë një pasqyrë të nivelit të zbatimit në disa aspekte, p.sh. zbërthimi i strategjisë në plane të aktiviteteve apo rregullative (si p.sh. PZHK në HZK apo PH), projekteve kapitale, programeve për ofrimin e shërbimeve të ndryshme komunale, programe për fuqizimin e kapaciteteve njerëzore etj. Mjete të tilla identifikojnë fushat në të cilat veprimet e ndërmarra janë në pajtim me strategjinë, si dhe nëse investimi ka arritur kontribuar në përmbushjen e qëllimit të synuar.

Mjete për pjesëmarrje të publikut. Pjesëmarrja aktive dhe gjithëpërfshirëse e publikut në procese vendim-marrëse është një nga parimet bazë të planifikimit strategjik dhe demokracisë lokale, e cila kontribuon në zhvillimin e institucioneve publike më transparente dhe të përgjegjshme. Një numër i konsiderueshëm i doracakëve për pjesëmarrje të publikut të përshtatura për kontekstin e Kosovës janë zhvilluar deri më tani. Disa prej tyre janë:

Udhëzues mbi pjesëmarrjen publike në planifikimin hapësinor

Zyra e UN-Habitatit në Kosovë, 2014

Vizionimi si mjet i planifikimit pjesëmarrës – të mësuarit nga praktikat e Kosovës

Zyra e UN-Habitatit në Kosovë, 2012

Integrimi gjinor në planifikimin hapësinor

Zyra e UN-Habitatit në Kosovë, 2014

Fuqizimi i pjesëmarrjes publike në vendimmarrje: në nivel komunal të qeverisjes

INPO, 2018

FUQIZIMI I KAPACITETEVE KOMUNALE PËR HARTIMIN DHE ZBATIMIN E STRATEGJIVE LOKALE. Komuna inicon vlerësimin e kapaciteteve njerëzore në fushat me interes strategjik për zhvillimin e Komunës, dhe ndërmerr masat e nevojshme për plotësimin e numrit të personave të angazhur, profileve të specializuara dhe fuqizimin e kapaciteteve ekzistuese. Duke pasur parasyshë kufizimet që komunat i kanë në angazhimin e stafit të rregullt në profile të caktuara, disa nga veprimet që komuna mund të ndërmarr janë:

Trajnimi i stafit aktual në hartimin e politikave lokale përkatësisht përpilimin e planeve apo strategjive, menaxhimin e procesit të hartimit të politikave lokale dhe monitorim të zbatimit të tyre. Sa i përket planifikimit hapësinor dhe mjedisor, Instituti Kosovar i Administratës Publike (IKAP) në vitin 2015 ka integruar katër module trajnuese, ndër to modulën për Hartimin e Planit Zhvillor Komunal dhe modulën për Vlerësim Strategjik Mjedisor të cilat janë në shërbim të shërbyesve civil.

Informimi i këshilltarëve komunal (anëtarëve të kuvendit komunal) rreth strategjive ekzistuese komunale, rolin, fushëveprimin dhe përmbytjes së tyre. Poashtu, përmirësimi i njohurive rreth ndërlidhjes së strategjive, buxhetit vjetor dhe projekteve kapitale komunale, si mbështetje të zhvillimit të qëndrueshëm të komunës.

Angazhimi i kompanive konsulente apo praktikantëve për sektor të ndryshëm. Komuna, përmes bashkëpunimit me institucionet edukativo arsimore apo konkurseve të hapura mund të angazhojë praktikant të profileve të ndryshme varësisht nga nevojat për periudha të shkurta kohore 6 muaj deri 1 vjet, me detyra të definuara. Kjo praktikë është dëshmuar shumë efektive përshkak të stafit të pamjaftueshëm, kreativitetit dhe njohurive rreth teknologjisë, dhe energjisë pozitive në vendin e punës. Në rast të angazhimit të praktikantëve komunat duhet të përcaktoj menaxherin dhe detyrat në mënyrë specifike për personat e angazhuar. Sa i përket angazhimit të kompanive konsulente dhe të tjera, Komuna duhet të përcaktoj qartë dhe sakt përmes Termave të Referencës detyrat dhe format e raportimit të progresit të punës për menaxhim më të mirëfillt.

KRIJIMI I BAZËS SË INTEGRUAR/ PËRMBLEDHËSE TË TË DHËNAVE KOMUNALE. Një nga sfidat globale të përmbushjes dhe raportimit rreth QZHQ-ve është mungesa e të dhënave të sakta, të përditësuara dhe të digjitalizuara. Ky hendikep pamundëson identifikimin e saktë dhe adresimin adekuat të problemeve apo sfidave që komunat dhe komuniteti i gjërë i hasin. Komuna zhvillon bazën e integruar të të dhënave komunale, e cila është në harmoni me bazën e të dhënave në sektor të ndryshëm dhe ministritë e linjës. Si e tillë, kjo bazë e të dhënave duhet të akomodojë lloje të ndryshme të të dhënave si ato hapësinore, numerike, tekstuale si dhe arkivin digjital. Për të rregulluar qasjen, periudhat dhe modalitetin e menaxhimit të bazës së integruar të të dhënave, komuna harton protokolet e menaxhimit të databazës dhe themelon grupin menaxhues të bazës së të dhënave.

Një platformë e tillë kontribuon në menaxhim të mirëfillt të zhvillimit të komunës, mundëson raportim të lehtë të përmbushjes së strategjive lokale dhe QZHQ-ve, institucione më efektive dhe më të përgjegjshme.

REFERENCAT

MAPS Mission Engagement and SDG Implementation Support, UNDP review of 2016-2017, Mainstreaming Acceleration and Policy Support country missions
<https://unstats.un.org/unsd/unsystem/Documents-Sept2018/BG-Item6-MAPS.pdf>

UCLG- United Cities and Local Governments (2015)
THE SUSTAINABLE DEVELOPMENT goals - WHAT LOCAL GOVERNMENTS NEED TO KNOW

United Nations General Assembly (2015)
TRANSFORMING OUR WORLD: THE 2030 AGENDA FOR SUSTAINABLE DEVELOPMENT

Kuvendi i Republikës së Kosovës, <http://www.kuvendikosoves.org/?cid=2.1,1139>

United Nations Kosovo Team, Ensure Healthy lives and promote well-being for all at all ages (2015)
<http://unkt.org/sdg/?goal=03>

United Nations Kosovo Team, The Sustainable Development Goals in Kosovo: An Agenda for the Future of Kosovovo (2015)
<https://docs.google.com/viewerng/viewwr?url=http://www.muon-dev.com/ëp-content/uploads/2017/06/Fact-sheet-SDGs-in-Kosovo-2017-Fin-.pdf&hl=en>

MAPS Mission Engagement and SDG Implementation Support, UNDP review of 2016-2017 Mainstreaming Acceleration and Policy Support country missions
<https://unstats.un.org/unsd/unsystem/Documents-Sept2018/BG-Item6-MAPS.pdf>

UCLG- United Cities and Local Governments, Local and Regional Governments Report to the 2018 HLPF 2nd Report (2018)
<https://www.gold.uclg.org/sites/default/files/Toëards the Localization of the SDGs.pdf>

UNKT-United National Kosovo Team, The United Nations Common Development Plan 2016-2020
<http://www.muon-dev.com/wp-content/uploads/2016/09/3.4-UNDAF-UNKT-CDP.pdf>

KS- Role of Local Governments in the Implementation of the Sustainable Development Goals (2016)

<https://www.ks.no/om-ks/ks-in-english/role-of-local-governments-in-the-implementation-of-the-sustainable-development-goals/>

GIZ German Cooperation, Agenda 20130 in my municipality (2019)
A handbook for practitioners for localizing the Sustainable Development Goals (SDGs)

Instituti GAP, Sa kane kompetenca vetanake Komunat? (2017)
https://www.institutigap.org/documents/94817_Gap%20Analiz%C3%AB%205%20kompetencat.pdf

Gazeta Zyretare e Republikes se Kosoves, LIGJI NR. 03/L-040 PËR VETËQEVERISJEN LOKALE (2008)
<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2530>

Gazeta Zyretare e Republikes se Kosoves, LIGJI NR. 04/L-174 PËR PLANIFIKIMIN HAPËSINOR (2013)
<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8865>

Komuna e Drenasit, Draft-Plani Zhvillimor i Komunës së Drenasit 2019 – 2027

Gazeta Zyretare e Republikes se Kosoves, UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 03/2012 - MAPL PËR KËSHILLAT KOMUNALE PËR SIGURI NË BASHKËSI (2012)
<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=8203>

UN HABITAT, Programi per mbeshtetje te planifikimit hapsinor komunal, Vizionimi si mjet I planifikimit pjesemarres te mesuarit nga praktikat e Kosoves(2012)
http://www.unhabitat-kosovo.org/repository/docs/Visioning-ALB_584536.pdf

UN HABITAT, Udhezues mbi pjesemarrjen publike ne planifikimin hapesinor (2014)
<http://www.unhabitat-kosovo.org/repository/docs/3. Udhezues mbi Pjesemarrjen Publike ne Planifikimin Hapesinor 388034.pdf>

Republika e Kosoves, Asociacioni I Komunave te Kosoves (2015)
http://www.unhabitat-kosovo.org/repository/docs/Gender_Mainstreaming_ALB_web_172353.pdf

SHTOJCA

Matrica e vlerësimit të pajtueshmërisë së PZHK-së me QZHQ-të

Objektivat	Pajtueshmeria e strategjive lokale me OZHQ	Qellimet, objektivat apo caqet relevante nga PZHK-te apo SZHEL	Nese pjeserisht apo nuk ka pajtueshmeri, elaboroni dallimet			
			Aspekti qe adresohet	Caku	Fushe-veprimi	Treguesit
1.1 Deri në vitin 2030, të zhduket varfëria ekstreme për të gjithë njerëzit kudo, e matur aktualisht me numrin e njerëzve që jetojnë sot me më pak se 1.25 \$ në ditë.	Nuk është trajtuar në mënyrë specifike					
1.2 Deri në vitin 2030, të zvogëlohet të paktën përgjysëm përqindja e burrave, grave dhe fëmijëve të të gjitha moshave, që jetojnë në varfëri, në të gjitha dimensionet e saj, në bazë të përcaktimeve kombëtare.	Nuk është trajtuar në mënyrë specifike					
1.3 Të zbatohen sistemet dhe masat e përshtatshme kombëtare të mbrojtjes sociale për të gjithë, përfshirë dhe shtresat e ulëta, dhe deri në vitin	Nuk është trajtuar në mënyrë specifike					

2030 të arrihet një mbulim i konsiderueshëm i njerëzve të varfër dhe të pambrojtur.						
1.4 Deri në vitin 2030, të sigurohet që të gjithë burrat dhe gratë, në veçanti njerëzit e varfër dhe të pambrojtur, të kenë të drejta të barabarta në përdorimin e burimeve ekonomike, si qasje në shërbimet minimale, pronësi dhe kontroll mbi tokën, si dhe në forma të tjera të pronësisë, të trashëgimisë, të burimeve natyrore, të teknologjive të reja të përshtatshme dhe të shërbimeve financiare, përfshirë dhe mikrofinancat.	Nuk është trajtuar në mënyrë specifike					

1.5 Deri në vitin 2030, të rriten aftësitë për të përballuar situatat e pafavorshme prej të varfërve dhe të atyre që jetojnë në gjendje të vështirë dhe të zvogëlohet ekspozimi dhe cënueshmëria e tyre ndaj ngjarjeve ekstreme të lidhura me klimën dhe fatkeqësitë e tjera ekonomike, sociale dhe mjedisore.	Nuk është trajtuar në mënyrë specifike					
2.1 Deri në vitin 2030, të eliminohet uria dhe të sigurohet e drejta e të gjithë njerëzve, në veçanti e të varfërve dhe e atyre që jetojnë në gjendje të vështirë, përfshirë foshnjat, për të patur ushqim të sigurt dhe të mjaftueshëm përgjatë gjithë vitit.	Nuk është trajtuar në mënyrë specifike					

2.2 Deri në vitin 2030, të eleminohen të gjitha format e kequshqyerjes, përfshirë edhe arritjen, deri në 2025-ën, të treguesve të miratuar ndërkombëtarisht lidhur me frenimin e zhvillimit të fëmijëve nën 5 vjeç dhe të adresohen nevojat për ushqim të vajzave adoleshente, të grave shtatzëna dhe atyre që ushqejnë foshnjat me gji, si dhe të personave të moshuar.	Nuk është trajtuar në mënyrë specifike					
2.3 Deri në vitin 2030, të dyfishohet prodhimi bujqësor dhe të ardhurat e prodhuesve ushqimorë në shkallë të vogël, veçanërisht e grave, popujve indigjenë, familjeve fermere, blegtorëve dhe peshkatarëve, përfshirë edhe përmes qasjes së sigurt dhe të barabartë tek	Pajtushmëri e pjesëshme	QËLLIMI 6 Zhvillimi rural dhe ruajtja e trashëgimisë natyrore Synimi 6.1 Vlerësimi i tokës pjellore bujqësore (përdorimi efikas i tokës bujqësore dhe mbështetja për produktivitet ekologjik, multi-funksionalitetit, tregut të fermerëve, shërbimet e sigurta për fshatrat rurale); Synimi 6.2 Mbështetja e fermerëve me mjete teknike ose financiare në ndërtimin e serrave, rregullimin dhe ndërtimin e fermave të vogla. Nxitjen e	Objektivi ka këtë përbërje dhe ka përputhshmëri të plotë me OZHQ-ne	Objektivi nuk e ka këtë përbërje	Objektivi ka këtë përbërje dhe përputhet pjesërisht me OZHQ-në	

toka, burimet e tjera prodhuese, njohuritë, shërbimet financiare, tregjet dhe mundësitë për shtimin e vlerës dhe punësimin jashtë sektorit bujqësor.		investimeve në pyllëzimin e përdorimi joefikas;				
